

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

BULETINI SHKENCOR

Buletini Shkencor, Edicion special - vol.3, 2023

BULETINI SHKENCOR

EDICION SPECIAL vol.3, 2023

ISSN: 2310-6719



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

FAKULTETI I SHËNDETIT

BULETINI SHKENCOR

Edicion Special vol.3, 2023

ISSN 2310-6719

Simpozium shkencor

KËRKIMI SHKENCOR SI ORIENTUES I POLITIKAVE SHËNDETËSORE

Qershor, 2023

Vlorë

Simpozium shkencor**KËRKIMI SHKENCOR SI ORIENTUES I POLITIKAVE SHËNDETËSORE**

Qershor, 2023

Simpoziumi shkencor 'Kërkimi shkencor si orientues i Politikave Shëndetësore' organizohet nga Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë si një nga mënyrat e promovimit të produkteve të arritura prej projekteve të kërkim-zhvillimit dhe infrastrukturës, të realizuara në kuadër të bashkëpunimit me Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Ky simpozium përmban tre sesione bazë gjatë të cilave do të prezantohen rezultatet e gjithë projekteve të realizuara fal bashkëpunimit me AKKSHI:

- ☐ Orientimi i politikave shëndetësore, si produkt final i kërkimit shkencor në Fakultetin e Shëndetit – do të prezantojë gjithë spektrin e bashkëpunimit të FSH me AKKSHI.
- ☐ Orientimi i politikave në Shërbimin Shëndetësor Parësor – do të prezantojë gjetje dhe rekomandime për disa aspekte të mjekësisë komunitare.
- ☐ Orientimi i politikave institucionale për zhvillimin e fëmijëve – do të diskutojë monitorimin në vazhdimësi të zhvillimit psikomotor të parashkollorëve.

Bashkëpunimi i Fakultetit të Shëndetit me Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka rezultuar mëse i suksesshëm në të dy komponentët e vet. Projektet e Infrastrukturës kanë siguruar struktura kërkimore të niveleve bashkëkohore, që kanë mundësuar jo vetëm një sërë studimesh shkencore nga stafi dhe studentët e fakultetit, por mbi të gjitha fitimin e dy Projekteve Kërkim-Zhvillimi të AKKSHI-t.

Për herë të parë akademikët e Fakultetit të Shëndetit patën mundësi ti shtrinin ambiciet e tyre shkencore në një fushë shumë të gjerë kërkimi, që do të sjell për pasojë përgjithësimin e rezultateve të studimit edhe në rang kombëtar. Synimi final i këtyre projekteve kërkimore mbetet dhënia e rekomandimeve për orientimin e politikave shëndetësore të bazuara në evidenca dhe siguri i një bashkëpunimi sistematik me strukturat shëndetësore dhe administrative për monitorimin e parametrave shëndetësorë të popullatës.

Health Research Symposium**FROM RESEARCH TO HEALTH POLICY IMPACT****June, 2023**

The symposium "From research to Health Policy impact " is organized by the Faculty of Health, "Ismail Qemali" University of Vlorë as one of the ways of promoting the products achieved by research-development and infrastructure projects, carried out in the framework of cooperation with the Agency National Institute of Scientific Research and Innovation (AKKSHI).

This symposium contains three basic sessions during which the results of all the projects realized thanks to the cooperation with AKKSHI will be presented:

- ☐ Orientation of health policies, as the final product of scientific research at the Faculty of Health - will present the entire spectrum of the cooperation of FSH with AKKSHI.
- ☐ Policy orientation in the Primary Health Service – will present findings and recommendations for some aspects of community medicine.

- ❑ Orientation of institutional policies for children's development - will discuss the ongoing monitoring of preschoolers' psychomotor development.

The collaboration of the Faculty of Health with the National Agency for Scientific Research and Innovation has been more successful in both of its components. Infrastructure projects have provided research structures of contemporary levels, which have enabled not only a series of scientific studies by the staff and students of the faculty, but above all the winning of two Research and Development Projects of AKKSHI.

For the first time, the academics of the Faculty of Health had the opportunity to extend their scientific ambitions in a very wide field of research, which will result in the generalization of the results of the study at the national level. The final goal of these research projects remains the provision of recommendations for the orientation of health policies based on evidence and ensuring a systematic cooperation with health and administrative structures for monitoring the health parameters of the population.

RRITJA E STANDARTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR AKADEMIK, SI REZULTAT I BASHKËPUNIMIT SISTEMATIK TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT ME AKKSHI

Prof Asoc Aurela Saliq

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit
Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Abstrakt

Hyrje: Fal bashkëpunimit me AKKSHI u arrit të mobilizohen në të njëjtin projekt një numër i konsiderueshëm kërkuesish shkencorë, në një ekip multidisiplinar, edhe nga struktura të tjera institucionale (Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor). Vëmendja që institucioni më i lartë shtetëror që udhëheq punën kërkimore në Shqipëri i ka kushtuar projekteve tona kërkimore, ka rritur vet-dijësimin për tu përfshirë në mënyrë më impenjative në këto projekte.

Qëllimi: Prezantimi i projekteve të kërkim-zhvillimit dhe infrastrukturës kërkimore të fituara nga Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' në kuadër të thirrjeve të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Rezultatet: projektet e fituara nga Fakulteti i Shëndetit në kuadër të thirrjeve të AKKSHI për Projekte Kombëtare të Infrastrukturës Kërkimore dhe për Projekte Kombëtare të kërkim-Zhvillimit janë:

Viti	Titulli i projektit	Drejtuesi i projektit
2019	Qendër kërkimore-shkencore për Shëndetin Publik	Prof.Dr. Yllka Stramarko
2021	Qendër Digitale Simulatore për profesionistët e shëndetit	Prof.asoc. Aurela Saliq
2021	Efikasiteti dhe perspektiva e ofrimit të shërbimit shëndetësor virtual pas pandemisë Covid.	Prof.asoc. Aurela Saliq
2022	Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë.	Dr.shk. Majlinda Zahaj
2022	Ngritja e database rajonal të vlerësimit të zhvillimit psikomotor dhe socio-emocional të fëmijëve 0-6 vjeç.	Prof.asoc. Aurela Saliq

Key words: Fakulteti i Shëndetit, AKKSHI, projekte kërkim-zhvillimi, projekte infrastrukturë.

INCREASING THE STANDARD OF ACADEMIC SCIENTIFIC RESEARCH, AS A RESULT OF THE SYSTEMATIC COOPERATION BETWEEN FACULTY OF HEALTH AND AKKSHI

Prof Asoc Aurela Saliqj

University 'Ismail Qemali' of Vlora, Faculty of Health
National Agency for Scientific Research and Innovation

Introduction

Thanks to the cooperation with AKKSHI, it was possible to mobilize in the same project a considerable number of scientific researchers, in a multidisciplinary team, also from other institutional structures (Regional Directorate of Health Care Services Operator). The attention that the highest state institution that leads the research work in Albania has paid to our research projects, has increased self-awareness to be more involved in these projects.

Aim

Presentation of research-development projects and research infrastructure acquired by the Faculty of Health, "Ismail Qemali" University within the call of the National Agency for Scientific Research and Innovation.

Results

The projects won by the Faculty of Health within the framework of AKKSHI's calls for National Research Infrastructure Projects and for National Research-Development Projects are:

Direct benefits from the FSH - AKKSHI cooperation: For the first time, the academics of our University had the opportunity to extend their scientific ambitions in a very wide field of research, which will result in the generalization of the study results at the national level. Thanks to the cooperation with AKKSHI, it was possible to mobilize in the same project a considerable number of scientific researchers, in a multidisciplinary team, also from other institutional structures (Regional Directorate of Health Care Services Operator). The attention that the highest state institution that leads the research work in Albania has paid to our research projects, has increased self-awareness to be more involved in these projects. The opportunity that is being given to us through the activities organized by AKKSHI to publish the practical applications resulting from our studies in front of panels with high state representatives, who are the potential users of our scientific recommendations, is the best opportunity that our scientific work not to remain at the theoretical level.

Indirect benefits from cooperation: Scientific research of these standards, with the support and patronage of AKKSHI, make it possible to generalize the research results even at the national level, giving this research credibility and dignity in international promotions. In the big international scheme, where every country is working to realize the formalization of the Virtual Health Service, the University of Vlora will present its scientific research recommendations based on the same study standards, and as a potential credible partner for future international projects.

Key words

Faculty of Health, AKKSHI, research and development projects, infrastructure projects.

Projektet e realizuara si rezultat i bashkëpunimit të Fakultetit të Shëndetit me Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)

Bashkëpunimi i Fakultetit të Shëndetit me AKKSHI ka qenë i suksesshëm në disa drejtime.

- Për herë të parë akademikët e Fakultetit të Shëndetit, Universiteti i Vlorës patën mundësi të shtrinin ambiciet e tyre shkencore në një fushë shumë të gjerë kërkimi, që do të sjell për pasojë përgjithësimin e rezultateve të studimit në rang kombëtar.
- Fal bashkëpunimit me AKKSHI u arrit të mobilizohen në të njëjtin projekt një numër i konsiderueshëm kërkuesish shkencorë, në një ekip multidisiplinar, edhe nga struktura të tjera institucionale (Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Bashkia Vlorë).
- Vëmendja që institucioni më i lartë shtetëror që udhëheq punën kërkimore në Shqipëri i ka kushtuar projekteve tona kërkimore, ka rritur vet-dijësimin për tu përfshirë në mënyrë më impenjative në këto projekte.
- Mundësia që na u dha me anë të aktiviteteve të organizuar nga AKKSHI për të publikuar aplikimet praktike që rezultojnë prej studimeve tona përpara paneleve me përfaqësues të lartë shtetëror, që janë përdoruesit e mundshëm të rekomandimeve tona shkencore, është mundësia më e mirë që puna jonë shkencore të mos ngelet në nivelin teorik.
- Kërkime shkencore të këtyre standarteve, me mbështetjen dhe patronazhin e AKKSHI-t, bëjnë të mundur përgjithësimin e rezultateve kërkimore edhe në nivel kombëtar, duke u dhënë këtyre kërkimeve kredibilitet dhe dinjitet në promovimet ndërkombëtare.
- Në skemën e madhe ndërkombëtare, ku çdo vend po punon për të realizuar formalizimin e Shërbimit Shëndetësor Virtual, Universiteti i Vlorës do të prezantojë rekomandimet e kërkimit të vet shkencor bazuar në të njëjtat standarte studimore, dhe si partner potencial kredibël për projektet e ardhme ndërkombëtare.

Projektet kërkimore-shkencore të ndërmarra në fushën e Shëndetësisë i kanë ndërtuar objektivat e tyre me synimin madhor për të kontribuar në zbatimin e Prioriteteve strategjike kombëtare dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Prioriteti strategjik sektorial 11.2:

Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm

Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke garantuar akses të plotë për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri.

Objektivi strategjik 5: Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe më të mirë koordinuar të kujdesit shëndetësor.

Lidhja me OZHQ (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm):

OZHQ 3 – Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

OZHQ 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë jetës për të gjithë.

Viti 2019 - "Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në kuadër të Paktit për Universitetin", shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2019.

Qendër kërkimore-shkencore për Shëndetin Publik

Drejtuesi i projektit:

Prof.Dr. Yllka Stramarko

Njësia bazë propozuese:

Qendra kërkimore-shkencore për Shëndetin Publik, Fakulteti i Shëndetit

Qëllimi i projektit:

Ngritja e një laboratorit kërkimor-shkencor për studime në fushën e Shëndetit Publik, që do të mbështesë survejancën e parametrave bio-shëndetësorë të popullatës, parandalimin e sëmundjeve komunitare dhe promovimin e jetës së shëndetshme.

Objektiva specifike:

1. Rritja e standarteve të kërkimit shkencor nga stafim akademik dhe studentët e Fakultetit të Shëndetit nëpërmjet mundësimit të studimeve epidemiologjike në komunitet.
2. Rritja e cilësisë së infrastrukturës didaktike në dispozicion të studentëve të programeve të Teknologjisë së laboratorit në Fakultetin e Shëndetit.
3. Përmirësimi i shëndetit komunitar nëpërmjet ofrimit të analizave cilësore, të shpejta dhe me kosto të ulët.
4. Rritja e qëndrueshmërisë financiare të FSH, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ndaj të tretëve (analiza biokimike dhe mikrobiologjike).

Rezultatet

- Laboratori klinik në përbërje të infrastrukturës didaktike të Fakultetit të Shëndetit është një element kyç në arritjen e standarteve bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies.
- Krijimi i kësaj qendre laboratorike në dispozicion të Qendrës Kërkimore-Shkencore të Shëndetit Publik do të rrisë ndjeshëm mundësitë e përfitimit të financimeve për zhvillimin e projekteve kërkimore në fushën e Shëndetit Publik.
- Ky laborator klinik do të ofrojë shërbime konkurruese ndaj të tretëve (analiza biokimike dhe mikrobiologjike), duke përbërë një kontribut të rëndësishëm financiar në të ardhurat dytësore të Fakultetit të Shëndetit.
- Për më tepër, edhe studentëve të programeve të Infermierisë (veçanërisht në programin Master i Shkencave) ky laborator u ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e temave studimore analitike.

Viti 2021 - Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2021.

Qendër Digitale Simulatore për profesionistët e shëndetit*Drejtuesi i projektit:*

Prof.asoc. Aurela Saliaj

Njësia bazë propozuese:

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

Qëllimi i projektit:

Zgjerimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor në programet e formimit të profesionistëve të shëndetit në të gjitha ciklet e studimit në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti i Vlorës, si dhe në aktivitetet e edukimit në vazhdimësi (Life Long Learning).

Objektivat specifike

Ngritja e Qendrës digitale simulatore, e pajisur me manekinë dhe aparatura simulatore me komandim digital dhe software për mësimdhënie virtuale.

Rezultatet

- Zgjerimi i gamës së projekteve kërkimore dhe të fizibilitetit në fushën e mësimdhënies për profesionistët e shëndetit.
 - Rritja e cilësisë së infrastrukturës didaktike në dispozicion të studentëve të programeve në Fakultetin e Shëndetit.
 - Rritja e aftësive profesionale të infermierëve të ardhshëm dhe personelit shëndetësor aktual.
 - Përmirësimi i shëndetit komunitar nëpërmjet trajnimeve profesionale për personat në nevojë.
 - Rritja e qëndrueshmërisë financiare të FSH, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ndaj të tretëve (trajnime profesionale, të akredituara nga QKEV).
-

Viti 2021 - Projekte Kombëtare Kërkim Zhvillimi (PKKZH), shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2021.

Efikasiteti dhe perspektiva e ofrimit të shërbimit shëndetësor virtual pas pandemisë Covid.

Drejtuesi i projektit:

Prof.asoc. Aurela Saliaj

Njësia bazë propozuese:

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

Qëllimi i projektit:

Vlerësimi i efikasitetit të shërbimit shëndetësor virtual dhe perspektiva për ndërthurjen e këtij shërbimi në kujdesin shëndetësor standart.

Objektivat specifike

1. Evidentimi i sfidave të komunikimit virtual dhe face-to-face me pacientët gjatë pandemisë: avantazhet dhe disavantazhet e secilës mënyrë komunikimi.
2. Vlerësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor në të dyja mënyrat e komunikimit.
3. Përcaktimi i kategorive të sëmundjeve apo elementëve që mund të jenë pjesë e përhershme e kujdesit shëndetësor.

Rezultatet

- Njohja me problematikat e komunikimit të ndërsjelltë person-pacient.
 - Përcaktimi i mënyrave më efikase të ofrimit të kujdesit sipas pacientëve dhe tipit të patologjisë.
 - Prezantimi i panoramës së marrjes së kujdesit shëndetësor gjatë periudhës së pandemisë.
 - Orientimi për strukturimin e shërbimit shëndetësor të së ardhmes, që do të ketë të ndërthurur shërbimin virtual dhe face-to-face.
 - Përcaktimi i kategorive (pacientë/patologji) që mund ta marrin cilësisht shërbimin shëndetësor më anë të komunikimit virtual edhe në periudhën pas-pandemisë.
 - Përcaktimi i elementeve që duhet të përfshijë një platformë teknologjike në funksion të shërbimit shëndetësor virtual për mjekun e familjes.
-

Viti 2022 - Projekte Kombëtare Kërkim Zhvillimi (PKKZH), shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2022.

Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë

Drejtuesi i projektit:

Dr.shk. Majlinda Zahaj

Njësia bazë propozuese:

Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit

Qëllimi i projektit:

Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinave të realizuara në popullatën e Vlorës si edhe niveli i antittrupave të krijuar tek këta individë sipas llojit të vaksinës.

Objektivat specifike

1. Evidentimi i popullatës që ka kryer procesin e vaksinimit (dozën e parë dhe është gati për dozën e dytë) dhe llojin e vaksinës.
2. Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinës pas secilës dozë të administruar.
3. Përcaktimi i nivelit të trupave të krijuar tek këta individë, nëpërmjet analizave të kryera 3 muaj pas realizimit edhe të dozës së dytë.
4. Evidentimi i keqinformimeve të popullatës mbi vaksinimin.

Rezultatet

- Njohja me problematikat që pacientët kanë patur pas aplikimit të secilës dozë.
- Përcaktimi i mënyrave më efikase të informimit rreth këtyre problematikave sipas grupit të individëve të përfshirë në popullatën që po studiohet.
- Krahësimi i numrit të individëve që duhet të paraqiten për administrimin e dozës së dytë dhe numrit real të individëve të paraqitur për administrim
- Përcaktimi i të gjithë elementeve që ndikojnë në hezitim e individëve në aplikimin e dozës së dytë të vaksinës.
- Kategorizimi i popullatës sipas antittrupave të krijuar pas procesit të vaksinimit, bazuar kjo në analizat e kryera 3-5 muaj pas realizimit edhe të dozës së dytë.
- Përcaktimi i kategorive (efekt anësor/vaksinë) në lidhje me efektet anësore. nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me individët e përfshirë në studim.

Viti 2022 - Projekte Kombëtare Kërkim Zhvillimi (PKKZH), shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2022.

Ngritja e database rajonal të vlerësimit të zhvillimit psikomotor dhe socio-emocional të fëmijëve 0-6 vjeç.

Drejtuesi i projektit:

Prof.asoc. Aurela Saliaj

Njësia bazë propozuese:

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit

Qëllimi i projektit:

Ngritja e një sistemi të besueshëm të vlerësimit dhe ndjekjes në vazhdimësi të zhvillimit psikomotor dhe socio-emocional në fëmijërinë e hershme në shërbimin shëndetësor parësor.

Objektivat specifike

1. Vlerësimi i strukturës së zhvillimit psiko-motor dhe socio-emocional të fëmijëve në qytetin e Vlorës dhe ngritja e Database monitorues për të.
2. Trajnimi i personelit të Shërbimit Pediatrik dhe stafit të Kopshteve shtetërore në Vlorë mbi depistimin e zhvillimit psikomotor në fëmijërinë e hershme.
3. Rekomandimi i ndryshimit të politikave shëndetësore të monitorimit të zhvillimit psikomotor në fëmijërinë e hershme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rezultatet

- Krijimi i arkivës së Grafikëve të Monitorimit të Zhvillimit Psikomotor të Fëmijëve 0-2 vjeç në Qendrat Ambulatore dhe Fëmijëve 2-6 vjeç të regjistruar në Kopshtet Shtetërore, bazuar në depistimin me anë të ASQ-3 dhe /ose ASQ-SE.
- Krijimi i Database të Monitorimit të Zhvillimit Psikomotor të Fëmijëve 0-6 vjeç në qytetin të Vlorës në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor – Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë.
- Rritja e kapaciteteve profesionale (në Qendrat ambulatorie dhe Kopshte) për identifikimin e devijacioneve dhe prapambetjeve në sektorë të ndryshëm të zhvillimit psikomotor në fëmijërinë e hershme dhe adresimin e problematikave të kësaj fushe.
- Krijimi i një sistemi të besueshëm për matjen në vazhdimësi të zhvillimit psikomotor të fëmijëve të moshës 0-6 vjeç.
- Depistimi i Zhvillimit Psikomotor të Fëmijëve 0-6 vjeç në Shërbimin Parësor (me anë të ASQ-3 dhe /ose ASQ-SE) të futet në protokollin e detyruara të vlerësimit shëndetësor periodik të fëmijëve të kësaj moshe.

Referencat:

1. Saliaj A, et al., (2023) *Psychomotor development among homeless institutionalized children in Albania and the impact of family connections*. International Journal of Ecosystems and Ecology Science (IJEES) Volume 13, issue 1, 2023 <https://doi.org/10.31407/ijeess> ISSN: 2224-4980 <https://doi.org/10.31407/ijeess13.1>
2. Saliaj A, et al., (2023) 'Can Cellphone Usage and Internet Addiction affect the Child Development?' HSOA Journal of Addiction & Addictive Disorders DOI: 10.24966/AAD-7276/100111. https://www.heraldopenaccess.us/article_pdf/2/can-cellphone-usage-and-internet-addiction-affect-the-child-development.pdf
3. Aurela Saliaj et al. (2023) *Perspektiva e ofrimit të shërbimit shëndetësor virtual pas pandemisë Covid-19*. Buletini shkencor i UV Numër 6, Vëllimi 1, 2023, ISSN 2310-6719.
4. Saliaj A. et al (2022) "Long-term impact of tobacco exposure during pregnancy on 3-6 year children's psychomotor development" 'Pediatrics international' Impact factor: 1.6. Online ISSN:1442-200X. <https://doi.org/10.1111/ped.15388>
5. Patelarou A, Saliaj A, et al. (2022) *Predictors of nurses' intention to accept COVID-19 vaccination: A cross-sectional study in five European countries*. J Clin Nurs. 2022 May;31(9-10):1258-1266. Impact factor: 4.4. doi: 10.1111/jocn.15980. Epub 2021 Jul 26. PMID: 34309114; PMCID: PMC8446965.
6. Zahaj M., et al (2021) "Analizimi i rasteve të covid-19 gjatë fazës së parë në rajonin e jugut të Shqipërisë. Arritjet dhe implikime të arrdshme për politikën shëndetësore." Buletini Shkencor Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Numër 4, Vëllimi 2, 2021 ISSN 2310-6719
7. Zahaj M., et al (2021) "Mental health kills covid-19 patients; a wake-up call from Albania" Buletini Shkencor Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Numër 4, Vëllimi 1, 2021, fq.57 ISSN 2310-6719.

DREJT VENDIMARRJES SË BAZUAR NË EVIDENCA – SHËNDETI PUBLIK NË SHQIPËRI GJATË PANDEMISË COVID-19, PËRVOJA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT, UNIVERSITETI I VLORES.

Enkeleint A. Mechili^{1,2}, Evis Alushi³, Aurela Saliq¹, Majlinda Zahaj³, Fatjona Kamberi⁴, Irini Rapushi⁴, Emirjona Kicaj¹, on behalf of all members of the Faculty of Health

Department of Healthcare, Faculty of Health, University of Vlora, Albania

School of Medicine, University of Crete, Heraklion, Greece

Department of Nursing, Faculty of Health, University of Vlora, Albania

Research Centre of Public Health, University of Vlora, Albania

Abstrakt

Hyrje: Pandemia e COVID-19 që filloi në dhjetor 2019 e gjeti sistemin e kujdesit shëndetësor të papërgatitur me mungesë të stafit dhe pajisjeve. Pandemia jo vetëm që prishi ofrimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore për ata në nevojë, por edhe i rrezikoi ata për shkak të transferimit të përpjekjeve në një drejtim të caktuar. Gjithashtu, problemet ekzistuese u shfaqën dhe e vështirësuan luftën kundër sëmundjes. Deri më tani, pandemia e COVID-19 ka shkaktuar më shumë se 333.050 raste dhe 3.592 vdekje në Shqipëri. Në këtë situatë të paprecedentë, autoritetet shëndetësore u përpoqën të përballonin shumë të panjohura për shkak të mungesës së provave dhe përvojave të mëparshme.

Qëllimi: Ky abstrakt synon të ndajë eksperiencat e Fakultetit të Shëndetit Publik në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali" gjatë pandemisë COVID-19 për vendimarrje të bazuar në fakte në fushën e shëndetit publik.

Rezultatet: Anëtarët e fakultetit gjatë pandemisë COVID-19 (prill 2020 – nëntor 2022) publikuan tetë (16) artikuj në Revista Ndërkombëtare. Katër prej tyre u fokusuan vetëm në të dhënat shqiptare ndërsa pjesa tjetër ishin studime shumëkombëshe. Artikujt u fokusuan në gjendjen e shëndetit mendor, frikën ndaj COVID-19, qëllimin për të pranuar vaksinimin kundër COVID-19, vizitat në spital dhe shkallën e vdekshmërisë, kontrollin e duhanit "përgjegjësia sociale, ndikimi i COVID-19 tek njerëzit me diabet, sugjerime për eksodin e pandemisë etj.

Përfundime: Këta artikuj synonin të kapnin situatën aktuale në Shqipëri për shkak të pandemisë COVID-19 si dhe t'u propozonin veprime specifike politikëbërësve për vendime të bazuara në prova. Ne besojmë se këta artikuj mund të ndihmojnë autoritetet shëndetësore dhe vendimarrësit shëndetësorë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor jo vetëm gjatë kësaj pandemie, por edhe në rast të emergjencave të tjera shëndetësore.

TOWARD EVIDENCE INFORMED DECISIONS IN PUBLIC HEALTH IN ALBANIA DURING THE COVID-19 PANDEMIC: EXPERIENCES FROM FACULTY OF HEALTH, UNIVERSITY OF VLORA

Enkeleint A. Mechili^{1,2}, Evis Alushi³, Aurela Saliq¹, Majlinda Zahaj³, Fatjona Kamberi⁴, Irini Rapushi⁴, Emirjona Kicaj¹, on behalf of all members of the Faculty of Health

Department of Healthcare, Faculty of Health, University of Vlora, Albania

School of Medicine, University of Crete, Heraklion, Greece

Department of Nursing, Faculty of Health, University of Vlora, Albania

Research Centre of Public Health, University of Vlora, Albania

Introduction

The COVID-19 pandemic that started in December 2019 found the healthcare system unprepared with a lack of staff and equipment. The pandemic not only disrupted the regular provision of healthcare services to those in need but also jeopardize them due to transfer of efforts to a specific direction. Additionally, the existing problems came into view and made more difficult the fight against the disease. Till now the COVID-19 pandemic has caused more than 333.050 cases and 3.592 deaths in Albania. In this unprecedented situation, healthcare authorities tried to deal with many unknowns due to the lack of evidence and previous experiences.

Aim

This abstract aims to share the experiences of the Faculty of Public Health at the University of Vlora "Ismail Qemali" during the COVID-19 pandemic for evidence-based decision making in the field of public health.

Results

The Faculty members during the COVID-19 pandemic (April 2020 – November 2022) published eight (16) articles in International Journals. Four of them focused only on Albanian data while the rest were multinational studies. The articles focused on mental health status, COVID-19 fear, intention to accept COVID-19 vaccination, hospital visits and mortality rate, tobacco control "social responsibility, impact of the COVID-19 on people with diabetes, suggestions for exodus of the pandemic etc.

Conclusions

These articles aimed to capture the actual situation in Albania due to COVID-19 pandemic as well as to propose specific actions to policymakers for evidence informed decisions. We believe that these articles can help health authorities and health decision makers in planning and offering healthcare services not only during this pandemic but also in case of other health emergencies.

Hyrje

Pandemia e COVID-19 që filloi në dhjetor 2019 e gjeti sistemin e kujdesit shëndetësor të papërgatitur, me mungesë stafi dhe pajisjesh. Pandemia jo vetëm që prishi ofrimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore për ata persona që ishin në nevojë, por edhe i rrezikoi ata për shkak të transferimit të përpjekjeve në një drejtim të caktuar. Gjithashtu, u shfaqën edhe problemet

ekzistuese dhe e vështirësuar më shumë luftën kundër kësaj sëmundjeje. Deri më tani, pandemia e COVID-19 ka shkaktuar më shumë se 333.050 raste dhe 3.592 vdekje në Shqipëri. Në këtë situatë të paprecedentë, autoritetet shëndetësore u përpoqën të përballonin shumë të panjohura për shkak të mungesës së provave dhe përvojave të mëparshme.

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është të ndajë eksperiencat e Fakultetit të Shëndetit Publik në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali" gjatë pandemisë COVID-19 për vendimmarrje të bazuar në fakte në fushën e shëndetit publik.

Metodologjia

Ky punim është një paraqitje e disa prej artikujve të botuar nga ana e anëtarëve të Fakultetit gjatë pandemisë COVID-19 (prill 2020 – nëntor 2022) të cilët publikuan tetë (16) artikuj në Revista Ndërkombëtare. Katër prej tyre u fokusuan vetëm në të dhënat shqiptare ndërsa pjesa tjetër ishin studime shumëkombëshe. Artikujt u fokusuan në gjendjen e shëndetit mendor, frikën ndaj COVID-19, qëllimin për të pranuar vaksinimin kundër COVID-19, vizitat në spital dhe shkallën e vdekshmërisë, kontrollin e duhanit "përgjegjësia sociale", ndikimi i COVID-19 tek njerëzit me diabet, etj.

Rezultatet

Në studimin e Athina Patelarou Enkeleint A. Mechili et.al ; "*Nursing students, mental health status during COVID-19 quarantine: evidence from three European countries*", i pari në Shqipëri dhe në mbarë botën, janë vlerësuar nivelet e depresionit tek studentët e universitetit, bachelor dhe master (infermiere/mami), dhe familjarëve të tyre gjatë periudhës së karantinës së pandemisë COVID-19. Ky studim ndërseksional i kryer në Universitetin e Vlorës ka përdorur pyetësin e shëndetit të pacientit (PHQ-9). Për përfshirjen e tyre në studim janë përdorur e-maillet institucionale të të gjithë studentëve aktivë. Ky studim zbuloi se më shumë se një e katërta e të dy popullatave u evidentuan me nivele të moderuara deri në të rënda të depresionit. Faktorët kryesorë që kontribuan në nivelet e larta të depresionit ishin: perceptimi se COVID-19 dhe karantina mund të shkaktojnë probleme në shëndetin e tyre (të të dy popullatave) dhe kënaqësia me masat parandaluese për popullatën e studentëve.

Studimi i Enkeleint A. Mechili, Aurela Saliq, Fatjona Kamberi et.al "*Is the mental health of young students and their family members affected during the quarantine period? Evidence from the COVID-19 pandemic in Albania*", pati si qëllim vlerësimin e nivelit të depresionit të studentëve të infermierisë (universitare dhe master) në Greqi, Spanjë dhe Shqipëri gjatë pandemisë COVID-19 si dhe për të identifikuar përcaktuesit e mundshëm të nivelit të depresionit (prill – maj 2020). Ky studim ndërseksional i kryer midis prillit dhe majit 2020, përdori pyetësor online për të vlerësuar nivelet e depresionit të studentëve të infermierisë. 787 studentë të infermierisë morën pjesë në studim, nga të cilët 83.9% ishin të gjinisë femërore, 92.9% beqarë dhe 94.7% jetonin me familjarët e tyre. Një e treta e popullsisë studentore të infermierisë përjetoi depresion të lehtë, me nivele më të larta depresioni të vërejtura për studentët spanjollë (59.1%) të ndjekur nga studentët shqiptarë (34.5%) dhe grekë (21.8%). Analiza e regresionit linear me shumë variacione identifikoi se studentët spanjollë përjetuan më shumë depresion sesa grekët dhe shqiptarët ($p < 0.001$). Gjithashtu, ulja e moshës u shoqërua me rritje të depresionit.

Që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19, ka pasur një rritje të nivelit të frikës nga virusi në popullatën e përgjithshme. Studimi "*Assessment of COVID-19 Fear in Five European Countries before Mass Vaccination and Key Predictors among Nurses and Nursing Students*" synonte të vlerësonte ndjenjat e frikës tek infermierët dhe studentët e infermierisë në pesë vende evropiane (Greqi, Shqipëri, Qipro, Spanjë dhe Kosovë). Mostra jonë përbëhej nga studentë

universitarë të infermierisë, të cilët ndiqnin mësimet online ose fizikisht të organizuara nga 7 universitete në vendet pjesëmarrëse. Është përdorur shkalla e frikës nga COVID-19 (FCV-19S) për të matur frikën nga koronavirusi. Infermierët përjetuan më shumë frikë nga COVID-19 sesa studentët e infermierisë (rezultati mesatar; përkatësisht 16.2 dhe 14.6, $p < 0.001$); rezultati mesatar total ishte 15.2 (devijimi standard; 5.9) me një diapazon nga 7 në 35. Sipas modelit të regresionit linear me shumë variabla, femrat (OR = 2,53, 95% CI = 1,89-3,15) dhe të martuara (OR = 0,86, 95% CI = 0,24-1,48) përjetuan më shumë frikë nga COVID-19. Nivelet e frikës nga COVID-19 ishin më të larta tek infermierët (OR = 0,87, 95% CI = 0,28–1,45) dhe tek ata me sëmundje kronike (OR = 0,86, 95% CI = 0,11–1,62). Pjesëmarrësit që jetonin në vende me vdekshmëri më të lartë nga COVID-19 kishin më shumë frikë nga sëmundja (grupi i mesëm kundrejt vdekshmërisë së ulët; OR = 1,88, 95% CI = 1,02–2,75, grupi i vdekshmërisë së lartë kundrejt të ulët; OR = 2,82, 95% CI = 1,89-3,74).

Vaksinimi i popullatës ishte sfida e radhës. Studimi "*Predictors of nurses' intention to accept COVID-19 vaccination: A cross-sectional study in five European countries*", kërkon të evidentojë synimin e infermierëve për pranimin e vaksinimit kundër COVID-19 dhe faktorët që ndikojnë në vendimin e tyre. Studimi u krye në Shqipëri, Qipro, Greqi, Spanjë dhe Kosovë me përdorimin e një pyetëso online, duke përdorur shkallën e frikës nga COVID-19. Njohuritë e vetë-perceptuara për COVID-19 ishin të larta deri në shumë të larta (65.1%), por të ulëta deri në shumë të ulëta për vaksinat e COVID-19 (44.1%). 65.3% e pjesëmarrësve pranuan disi ose plotësisht një vaksinë të sigurt dhe efektive për COVID-19, ndërsa vetëm 8.6% nuk ishin dakord. Besimi tek mjekët dhe tek ekspertët e qeverisë për informacionin për COVID-19 ishte përkatësisht 74% dhe 62.6%.

Infermierët nga Greqia dhanë përqindjen më të lartë të përgjigjeve pozitive në lidhje me pranimin e një vaksine të sigurt dhe efektive për COVID-19. Analiza me shumë variabla identifikoi se rritja e frikës nga COVID-19 dhe rritja e njohurive të vetë-perceptuara për vaksinat COVID-19 lidheshin me synimin e shtuar për të pranuar vaksinimin kundër COVID-19.

Studimi "*Factors influencing nursing students' intention to accept COVID-19 vaccination: A pooled analysis of seven European countries*", u realizua për të evidentuar synimin e studentëve të infermierisë për t'u vaksinuar për SARS-CoV-2 dhe faktorët që veprojnë si motivues apo si barriera ndaj vaksinimit. Ky studim u krye në 7 universitete të vendeve pjesëmarrëse (Greqi, Shqipëri, Qipro, Spanjë, Itali, Republikën Çeke dhe Kosovë) nëpërmjet një sondazhi në internet. Të dhënat u mbledhën gjatë dhjetorit 2020–janar 2021 në të gjitha vendet. Rezultati mesatar në shkallën e frikës nga COVID-19 ishte 14.7 (devijimi standard = 5.9). 43.8% e pjesëmarrësve (disi ose plotësisht) ranë dakord të pranonin një vaksinë të sigurt dhe efektive për COVID-19, ndërsa 22.2% (disi ose plotësisht) nuk u pajtuan për ta pranuar këtë vaksinë. Arsyeja më e rëndësishme për refuzimin e një vaksine COVID-19 ishin dyshimet për sigurinë, efikasitetin dhe efektivitetin e vaksinës (72.4%). Analiza me shumë variabla tregoi se meshkujt (OR = 1,41, $p = 0,008$) dhe studentët që nuk punonin në institucione të kujdesit shëndetësor, gjatë pandemisë COVID-19 (OR = 1,58, $p = 0,001$) ishin më të gatshëm të pranonin vaksinimin ndaj COVID-19. Besimi te qeveria (OR = 1,85, $p < 0,001$), te mjekët në lidhje me informacionin për COVID-19 (OR = 2,13, $p < 0,001$) dhe te ekspertët e qeverisë në lidhje me informacionin që ata përcillnin për COVID-19 (OR = 1,40, $p = 0,012$) rriti probabilitetin për t'u vaksinuar kundër COVID-19.

COVID-19 çoi në një sëmundshmëri dhe vdekshmëri të gjerë ku spitalet dhe sistemet e kujdesit shëndetësor u përballën me një barrë financiare katastrofike për shkak të kësaj sëmundjeje. Problemi i kapaciteteve ndikon në cilësinë e kujdesit shëndetësor, duke i bërë pacientët më të prekshëm ndaj komplikacioneve të sëmundjeve.

Studimi *"Decreased Hospital Visits and Increased Mortality Rate in Emergency Department during the COVID-19 Pandemic: Evidence from Albania"* synonte të evidentonte vizitat spitalore dhe shkallën e vdekshmërisë gjatë COVID-19 në urgjencën e spitalit rajonal të Vlorës në Shqipëri dhe t'i krahasonte ato me të dhënat e tre viteve të mëparshme (2017-2019). Ky studim retrospektiv përfshiu pacientë që vizituan urgjencën e Spitalit Rajonal Vlorë, që nga 1 janari 2017 deri më 31 dhjetor 2020, të gjithë pacientët e pranuar dhe të regjistruar në regjistrin e urgjencës të spitalit të lartpërmendur. Popullata e studimit përfshinte 44,917 pacientë gjatë 2017-2020. Një rritje e numrit të pacientëve të paraqitur me disa sëmundje është vërejtur në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 – kardiovaskulare (18.7% në 22.2%), psikiatrike (0.4% në 3.4%) dhe traktit renal/urinar (5% në 6.8%). Një rënie e ndjeshme është vërejtur për sëmundjet e tjera në të njëjtën periudhë – neurologjike (17,1% në 13,7%), pulmonare (3,6% në 2,9%), infeksione (21,5% në 17,2%) dhe gastrointestinale (21,6% në 16%). Me kalimin e kohës, numri i pacientëve u ul me një rënie mesatare vjetore në përqindje prej 7% (p-value=0.22).

Gjithashtu me kalimin e kohës u ul numri i pacientët meshkuj dhe femra, me një rënie mesatare vjetore në përqindje përkatësisht 4.5% (p-value=0.34) dhe 9% (p-value=0.16). Numri i pacientëve mbi 80 vjeç u rrit me një mesatare vjetore prej 1.6% (p-value=0.87). Gjithashtu ky studim zbuloi se gjatë pandemisë COVID-19 numri i pacientëve që vizitonin urgjencën u ul, ndërsa shkalla e vdekshmërisë u rrit.

Konkluzione

Referuar të gjitha të dhënave të studimeve të mësipërme të realizuara nga pedagogët e FSh mund të themi se:

- Nivelet e depresionit ishin të larta gjatë periudhës së karantinës COVID-19.
- Frika nga COVID-19 ishte e lartë.
- Nivelet e vaksinimit nuk ishin shumë të kënaqshme.
- Vizitat në repartin e urgjencës u paraqitën të ulta, ndërsa shkalla e vdekjeve e lartë.
- Evidentuar se përdorimi i shkencës për vendimet e kujdesit shëndetësor u bazua në prova të mirëfillta.

Pra këta artikuj synonin të evidentonin situatën aktuale në Shqipëri, për shkak të pandemisë COVID-19, si dhe t'u propozonin veprime specifike politikëbërësve për vendime të bazuara në prova. Gjithashtu këta artikuj mund të ndihmojnë autoritetet shëndetësore dhe vendimmarrësit shëndetësorë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor jo vetëm gjatë kësaj pandemie, por edhe në rast të emergjencave të tjera shëndetësore.

Referencat:

1. Is the mental health of young students and their family members affected during the quarantine period? Online ISSN:1442-200X 'Journal of psychiatric and mental health nursing'. Impact factor:1.947 First published: 13 July 2020. <https://doi.org/10.1111/jpm.12672>, PMC: <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7405232>
2. Global investments in pandemic preparedness and COVID-19: development assistance and domestic spending on health between 1990 and 2026. The Lancet Global Health (2023). doi: 10.1016/S2214-109X(23)00007-4. 6. A multinational Delphi consensus to end the COVID-19 public health threat. Nature (2022). <https://doi.org/10.1038/s41586-022-05398-2>.
3. Severity and Mortality Predictors of COVID-19 Patients with Thrombotic Events-Evidence from the "COVID-One" Hospital in Albania. Vaccines 2022, 10, 1851. <https://doi.org/10.3390/vaccines10111851> 8. Evidence-Based Conceptual Collection of Methods for Spatial Epidemiology and Analysis to Enhance Cancer Surveillance and Public Health. Int. J. Environ. Res. Public Health 2022, 19, 12765. <https://doi.org/10.3390/ijerph191912765> 9.

4. Decreased Hospital Visits and Increased Mortality Rate in Emergency Department during the COVID-19 Pandemic: Evidence from Albania. *Acta Medica Lituanica* 29 (1), 13. <https://doi.org/10.15388/Amed.2022.29.1.13>.
5. Assessment of COVID-19 Fear in Five European Countries before Mass Vaccination and Key Predictors among Nurses and Nursing Students. *Vaccines* **2022**; 10(1), 98; <https://doi.org/10.3390/vaccines10010098>.
6. Predictors of nurses' intention to accept COVID-19 vaccination: A crosssectional study in five European countries. *J Clin Nurs*. **2021**;00:1–9. 20. Factors influencing nursing students' intention to accept COVID-19 vaccination: A pooled analysis of seven European countries. *Nurse Education Today*. 104 (2021) 105010.
7. Nursing students, mental health status during COVID-19 quarantine: evidence from three European countries. *J Ment Health* Jan 28;1-6. doi: 10.1080/09638237.2021.1875420.
8. Development and Validation of a Questionnaire to Measure Knowledge of and Attitude toward COVID-19 among Nursing Students in Greece. *Nurs. Rep.* **2020**, 10, 82–94; doi:10.3390/nursrep10020012.
9. Effect of COVID-19 pandemic on mental health among Albanian people residing in the country and abroad – Implications for mental care. *Arch Psychiatr Nurs.* (**2020**). <https://doi.org/10.1016/j.apnu.2020.08.003>
10. Primary healthcare personnel challenges and barriers on the management of patients with multimorbidity in Albania. *Health Soc Care Community*. **2022** Jan;30(1):380-388. Impact factor: 2.4. doi: 10.1111/hsc.13411. Epub 2021 May 6. PMID: 33956363.

EFIKASITETI DHE PERSPEKTIVA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR VIRTUAL PAS PANDEMISË COVID.

Emirjona Kiçaj, Aurela Saliaj, Ina Islamaj, Majlinda Zahaj, Enkelejd Mëhilli, Juliana Xhindoli, Sonila Nikaj, Stiliana Brokaj, Inis Hoxhaj.

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit
Drejtoria Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë
Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Abstrakt

Hyrje: Shëndetësia virtuale është një komponent kyç i vizionit shëndetësor të së ardhmes. Ajo ka aftësinë për të informuar, personalizuar dhe përshpejtuar parandalimin e sëmundjeve dhe kujdesin shëndetësor.

Qëllimi: Vlerësimi i efikasitetit të shërbimit shëndetësor virtual dhe perspektiva për ndërthurjen e këtij shërbimi në kujdesin shëndetësor standart.

Metodologjia: Ky studim është zhvilluar në kuadër të programit të AKKSHI për Projekte Kombëtare të Kërkim Zhvillimit 2021. Studimi është kryer në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë dhe ka përfshirë personelin mjekësor dhe pacientët e Shërbimit Parësor në Rajonin e Vlorës. Ky është një studim kros-seksional, i kombinuar: cilësor dhe sasior. Instrumenti matës: Intervista gjysmë e strukturuar, e pregatitur nga grupi i punës.

Rezultatet: Në total janë intervistuar 31 mjekë pediatër, 28 mjekë për adultët, 33 infermiere pediatre, 45 infermiere adulti, 35 pacientë dhe 27 prindër fëmijësh nga 52 qendra shëndetësore në tre qarqe: Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë. Si avantazhe të komunikimit virtual gjatë pandemisë u evidentuan: planifikimi i vizitave të të sëmurëve kronikë për të mos pasur mbingarkesë, rritja e kontaktit me pacientët, siguri i aksesit më të mirë në marrjen e shërbimit, disponibilitet 24 orësh, shpejtimi i kohës së marrjes së shërbimit shëndetësor, përmirësimi i monitorimit të të sëmurëve kronikë dhe fëmijëve, rritja e aksesit të pacientëve në pamundësi fizike.

Konkluzionet: Shërbimi shëndetësor virtual duhet të vazhdojë edhe pas kalimit të pandemisë, së paku në dy komponente: triazhimi i vlerësimit të parë të pacientit dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore në vazhdimësi.

Fjalët kyçe: shërbimi shëndetësor virtual, pandemia Covid-19

EFFICIENCY AND PERSPECTIVE OF PROVIDING VIRTUAL HEALTH SERVICE AFTER THE COVID PANDEMIC.

Emirjona Kiçaj, Aurela Saliaj, Ina Islamaj, Majlinda Zahaj, Enkelejd Mehili, Juliana Xindoli, Sonila Nikaj, Stiliana Brokaj, Inis Hoxhaj.

University 'Ismail Qemali' of Vlora, Faculty of Health
The Regional Directorate of the Health Care Services Operator of Vlora
National Agency for Scientific Research and Innovation

Introduction

Virtual health is a key component of the health vision of the future. It has the ability to inform, personalize and accelerate disease prevention and health care.

Purpose

Evaluation of the efficiency of the virtual health service and the perspective for integrating this service into standard health care.

Methodology

This study was developed within the AKKSHI program for National Research and Development Projects 2021. The study was carried out in cooperation with the Regional Directorate of the Vlora Health Care Services Operator and included the medical staff and patients of the Primary Service in the Vlora Region. . This is a cross-sectional study, combined: qualitative and quantitative. Measuring instrument: Semi-structured interview, prepared by the working group.

Results

In total, 31 pediatricians, 28 adult doctors, 33 pediatric nurses, 45 adult nurses, 35 patients and 27 parents of children from 52 health centers in three counties were interviewed: Vlorë, Fier and Gjirokastër. The advantages of virtual communication during the pandemic were identified as: scheduling visits of chronically ill patients to avoid overload, increasing contact with patients, ensuring better access to receiving services, 24-hour availability, speeding up the time of receiving health service, improving the monitoring of chronic patients and children, increasing the access of physically disabled patients.

Conclusions

The virtual health service should continue even after the pandemic has passed, at least in two components: the triage of the first assessment of the patient and the monitoring of the health status on an ongoing basis.

Keywords: *virtual health service, Covid-19 pandemic*

Hyrje

Shëndetësia virtuale është një komponent kyç i vizionit shëndetësor të së ardhmes. Ajo ka aftësinë për të informuar, personalizuar dhe përsheptuar parandalimin e sëmundjeve dhe kujdesin shëndetësor⁽¹⁾. Virtual Health Care (VHC) ka qenë ndryshimi pozitiv që pandemia Covid 19 solli në sistemin shëndetësor në botë. Pandemia e Covid-19 ka përsheptuar, ato që do të ishin dashur vite (ose edhe dekada) për tu ndryshuar, në ndoshta dymbëdhjetë muajt më transformues që industria shëndetësore ka parë ndonjëherë^(1,2).

Pyetjet më të rëndësishme që janë ngritur për këtë shërbim të ri shëndetësor janë: a e cënon cilësinë e shërbimit shëndetësor kjo formë ofrimi? A është gjithëpërfshirëse kjo formë mjekësie? A ka grupe popullsie që përjashtohen nga ky shërbim? ^(3,4,5)

E rëndësishme është të përcaktohen grupet e popullatave që përjashtohen dhe faktorët që ndikojnë në këtë përjashtim. Nga studimet e shumta vihej re se mosha e tretë kishte më pak akses në format e teknologjisë që siguronin këtë shërbim^(1,4). Pasja e një pajisjeje që ofron shërbim me zë, video apo foto, sigurimi i aksesit 24h në internet, cilësia e mirë e lidhjes së internetit bënte që të kishte diferenca në grupet e popullateve që kishin mundësi ta shfrytëzonin këtë shërbim^(1,5,6).

Studimet treguan se kishte akses të lartë të shërbimit shëndetësor nga zonat rurale dhe me distanca të largëta nga qendrat shëndetësore. Pacientët kishin akses shumë më të lartë ndaj shërbimit të specializuar. Kostot e reduktuara, nevoja më e paktë për tu shkëputur nga puna (pjesë e kostos), ulja e nevojës për të udhëtuar, shkurtimi i kohës në boxet e triazhimit, shëndet

më i mirë për shkak të monitorimit më të mirë të sëmundjes kanë qenë avantazhet e vërejtura në studimet e huaja^(7,8).

Një nga çështjet e tjera të studimeve kanë qenë se cilat disiplina të mjekësisë mund të përshkaten pa ulur cilësinë e shërbimit në këtë dimension të ri të mjekësisë - virtual health care. Disa nga shërbimet e propozuara janë: Shërbimi i Psikiatrisë, Dermatologjisë, Gjinekologjisë, Endokrinologjisë, Kardiologjisë, Gastroenterologjia dhe Onkologjia^(9,10). Një tjetër pikë e rëndësishme e studimeve ka qenë mjekësia e urgjencës: avantazhet dhe disavantazhet e telemedicinës në këtë shërbim. Ndërthurja e shërbimit të urgjencës pa e humbur efikasitetin në diagnozë dhe trajtim të patologjive që referohen në këtë shërbim. Në shumë studime tërhiqte vëmendjen fakti që në shërbimet e patologjive akute kishte interes në kryerjen e shërbimeve in-person, dhe avantazhi kryesor është lehtësimi i fazës së triazhimit në shërbimin e urgjencës^(11,12,13).

Të një rëndësie të madhe kanë qenë studimet që vlerësonin nëse ky shërbim i ndërthurur preferohej në patologjitë akute apo kronike apo nëse vendosja e pikave kryesore të diagnozës dhe trajtimit kërkonte me domosdoshmëri follow up in person. Interesant ishte fakti që patologjitë kronike kishin lehtësi ndjekjeje me këtë shërbim, dhe nga ana tjetër patologjitë akute kishin si domosdoshmëri për vlerësimin e saktë ndjekjen in person^(11,13). Në përfundim mund të themi që shërbimet online janë futur në përditshmërinë e punës sonë për të mos u larguar më, sfida jonë tani është ti validojmë dhe menaxhojmë ato.

Në kuadër të globalizimit VCH do të prekte pashmangshmërisht edhe vendin tonë dhe sistemin tonë shëndetësor. I kushtëzuar nga kushtet e reja prej mëse një viti, personeli shëndetësor ka qenë detyruar të zbatojnë rregulla strikte për distancimin shoqëror, duke rezultuar në adoptimin e shpejtë të teknologjive për të mundësuar sigurimin e kujdesit shëndetësor në distancë. Si Shërbimi Kombëtar i urgjencës, si mjekët e familjes, madje edhe specialistët e Shërbimeve Dytësore kanë përdorur gjerësisht komunikimin telefonik për të diagnostikuar, triazhuar dhe trajtuar pacientët⁽¹⁴⁾.

Dy çështje të paadresuara tërësisht sot, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel global, janë dokumentimi i komunikimit shëndetësor online, përderisa komunikimi telefonik ka qenë i paformalizuar, si dhe përlllogaritja e kostos së këtij shërbimi si për t'ia faturuar përfituesit, ashtu edhe për t'ia paguar ofruesit.

Nëpërmjet studimit aktual u morr përsipër të merrej një vlerësim i përgjithëm mbi efikasitetin e funksionimit të shërbimit shëndetësor virtual gjatë pandemisë Covid-19, si nga ofruesit si nga përfituesit e tij, si dhe perspektivën për ndërthurjen e VHC në kujdesin shëndetësor standart.

Metodologjia:

Ky studim është zhvilluar në kuadër të programit të AKKSHI për Projekte Kombëtare të Kërkim Zhvillimit 2021. Studimi është kryer në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë dhe ka përfshirë personelin mjekësor dhe pacientët e Shërbimit Parësor në Rajonin e Vlorës. Studimi është kros-seksional, cilësor.

Si instrument matës u përdor një Intervistë gjysmë e strukturuar, e pregatitur nga grupi i punës. U zhvilluan dy tipe intervistash: intervistim për personel shëndetësor dhe intervistim për pacientë, me disa ndryshime ndërmjet tyre. Intervistat përmbanin nga 20 pyetje, të ndarë në 4 rubrika: Të dhënat socio-demografike; Si ka funksionuar shërbimi mjekësor virtual gjatë pandemisë Covid-19? Cilët elementë të shërbimit vazhdojnë të funksionojnë akoma virtualisht? Cilat shërbime shëndetësore mendoni se mund të funksionojnë virtualisht pa cenuar cilësinë e shërbimit? (shtojca 2). Anëtarët e grupit të punës që realizuan intervistimet, kryen një seri trajnimesh për të unifikuar mënyrën e komunikimit dhe orientimin e të intervistuarve.

Në fund të bashkëbisedimit të intervistuarve iu paraqitën elementet paraprakë të një Platforme digjitale për Shërbimin Shëndetësor Virtual (shërbimi parësor), e pregatitur nga grupi

i punës së projektit (shtojca 1). Intervistat u dokumentuan me regjistrim audio, më pas u zbardhën dhe u koduan. Kodimi manual tematik u realizua në mënyrë të pavarur prej dy anëtarëve të grupit të punës.

Së pari u krye një studim pilot (N=18) me të intervistuar nga të gjitha grupet e përcaktuara: mjekë, infermierë dhe pacientë. Në përfundim të tij, intervistimi u riorganizua në korrektim të problematikave që rezultuan gjatë zbatimit të projektit. Përmbajtjet e intervistave gjithashtu u riformuluan dhe u grupuan për të qenë më të kuptueshme nga të intervistuarit.

Rezultatet:

Në total janë intervistuar 31 mjekë pediatër, 28 mjekë për adultët, 33 infermiere pediatre, 45 infermiere adulti, 35 pacientë dhe 27 prindër fëmijësh nga 52 qendra shëndetësore në tre qarqe: Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë.

Shkalla e kënaqësisë së pacientëve dhe prindërve në marrjen e shërbimit virtual u raportua në masën 96%, ndërsa nga ana e mjekëve dhe infermierëve respektivisht 81% dhe 88%.

Si avantazhe të komunikimit virtual gjatë pandemisë u evidentuan: planifikimi i vizitave të të sëmurëve kronikë për të mos pasur mbingarkesë, rritja e kontaktit me pacientët, siguri i aksesit më të mirë në marrjen e shërbimit, disponibilitet 24 orësh, shpejtimi i kohës së marrjes së shërbimit shëndetësor, përmirësimi i monitorimit të të sëmurëve kronikë dhe fëmijëve, rritja e aksesit të pacientëve në pamundësi fizike.

Disavantazhe nga ana e mjekëve dhe infermierëve u cilësuan mungesa e lehtësisë diagnostike të vizitës in-person, abuzivizmi nga ana e pacientëve (fillojnë të marrin në cel edhe për muhabet, se të konsiderojnë si familjar), lodhja fizike dhe mendore për personelin, sepse punon i mbingarkuar (kur VHC jepet pas orarit të punës). Pacientë përmendën si disavantazhe: 'Bezdiset doktoresha, se e shqetësonim orë e pa orë', 'Më duket sikur sqarohem më mirë kur e takoj doktoreshëm, sesa në telefon'. Ata preferonin të komunikonin me mjekët, sepse u dukeshin më të besueshëm dhe të qartë në adresimin e problemeve të tyre: 'Me infermierin më mirë të komunikosh online, ai të udhëzon, është më praktik. Me mjekun është më mirë të takohesh, sesa të flasësh online'.

Aktualisht u raportua në shërbimin shëndetësor parësor vazhdojnë të funksionojnë plotësisht apo pjesërisht virtualisht: marrja e recetës online, marrja e rekomandimit online, ndjekja e gjendjes pas bërjes së vaksinës (tek fëmijët), vendosjen e takimeve dhe prenotimeve, diagnostikimi i parë, rekomandimet për analiza.

87-98% e personelit shëndetësor, respektivisht infermierë dhe mjekë, ishin pro vazhdimin të pjesshëm të shërbimit shëndetësor virtual, sidomos në dy komponente kryesore: triazhimit të problemit shëndetësor të raportuar nga pacienti dhe monitorimit të gjendjes shëndetësore, sidomos tek të sëmurët kronikë. Pacientët ishin më skeptikë në këtë drejtim, pasi u dukej se merrnin vëmendje më të madhe në vizitat face-to-face, por sidomos infermierët e pyetur u shprehën se: 'Komunikimi online i bën pacientët të ndjehen më pak të neglizhuar'.

Perceptimi i shërbimit shëndetësor virtual (rezultatet në përqindje)			
	mjek	infermier	pacient
Funksionimi i shërbimit mjekësor virtual gjatë pandemisë Covid-19?			
<i>Si mendoni se ka funksionuar shërbimi online gjatë periudhës së pandemisë?</i>			
▪ po, ka funksionuar mirë	81	88	96
▪ jo, nuk i zgjidhnim dot situatat shëndetësore	3	7	1
▪ disi – jo gjithmonë, herë mbaronim punë, herë jo.	16	5	3

<i>Si ka qenë përqindja e vizitave ambulatorore në raport me telefonatat në periudhat e pikut Covid (tetor 2020-qershor 2021)?</i>			
▪ shumë pak online	7	21	7
▪ 50% - 50%	70	64	55
▪ 60% online	23	15	38
<i>A kanë tendencë pacientët të mbipërdorin aksesin tek mjeku, me telefonata? A kanë të njëjtën qasje për ta takuar mjekun in-person?</i>			
▪ Po, është abuzuar me mundësinë e marrjes në cel. (në kohë dhe në nevojë).	76	69	13
▪ Jo, nuk kanë marr në cel për arsye të panevojshme.	0	2	77
▪ Disi, ka pasur pacientë të rezervuar, ka pasur edhe nga ata që merrnin në cel për çdo hollësi.	24	29	10
<i>Kë metodë vizitash preferoni më shumë: in-person apo online?</i>			
▪ Online	18	35	4
▪ In-person	48	28	75
▪ Njësoj të dyja (50-50%)	34	37	21
<i>Telefonatat nga pacientët kanë qenë më së shumti për të pyetur /për të marrë informacione (procedura, informim mbi sëmundjet) apo për të kërkuar shërbim?</i>			
▪ Për të marr informacione: procedura, interesim për shëndetin	76	82	78
▪ Për të kërkuar shërbime shëndeti	10	16	11
▪ Njësoj	14	2	11
<i>A e keni pasur të lehtë përdorimin e teknologjisë për VHC?</i>			
▪ Po, e kam pasur të lehtë.	97	82	76
▪ Jo, e kam pasur të vështirë të ambientohesha.	3	18	24
<i>Mjeti më i shpeshtë i komunikimit</i>			
▪ Telefonatë	87	98	95
▪ Mesazhe	73	45	79
▪ What's up / Viber – video call	57	37	63
▪ Facebook / Instagram	6	11	4
<i>Diagnozat janë vënë më të sakta</i>			
▪ online	0	0	-
▪ in-person	93	88	-
▪ pa ndryshim	7	12	-
<i>Ndjekja e pacientit ka qenë më e mirë</i>			
▪ online	72	83	-
▪ in-person	23	12	-
▪ pa ndryshim	5	5	-
<i>Më të informuar për progresin e sëmundjes kemi qenë:</i>			
▪ online	-	-	47
▪ in-person	-	-	45
▪ pa ndryshim	-	-	8
<i>Shërbimi shëndetësor ka qenë më efikas:</i>			
▪ online	37	41	17
▪ in-person	63	54	40
▪ pa ndryshim	0	5	43
<i>Akcesi në marrjen e shërbimit shëndetësor ka qenë më i mirë:</i>			
▪ online	86	91	95
▪ in-person	10	8	3
▪ pa ndryshim	4	1	2
<i>Ndërgjegjësimi i pacientit për një jetë më të shëndetëshme</i>			

▪ është rritur	59	64	71
▪ është ulur	4	3	3
▪ pa ndryshim	37	33	26
Elementët e shërbimit shëndetësor që vazhdojnë të funksionojnë akoma virtualisht?			
<i>Si kanë ndryshuar tani përqindjet e shërbimit in-person dhe online?</i>			
▪ s'ka fare online	0	0	0
▪ janë ulur shumë	85	65	65
▪ janë rritur	2	7	20
▪ njësoj	13	28	15
<i>A ka kërkesa nga pacientët për shërbime online (të pjeshme)?</i>			
▪ Nuk ka kërkesa, çdo gjë e duan në ambulancë.	12	39	28
▪ Vijnë në ambulancë, por disa gjëra i duan me cel.	79	56	64
▪ Duan çdo gjë me komunikim online, si në pandemi.	9	5	8
<i>Për cilat shërbime specifikisht? (sugjerime)</i>			
▪ Marrja e recetës online			
▪ Marrja e rekomandimit online			
▪ Ndjekja e gjendjes pas bërjes së vaksinës (tek fëmijët)			
▪ Vendosjen e takimeve, prenotimeve			
▪ Diagnostikimi i parë			
▪ Rekomandimet për analiza			
Shërbimet shëndetësore që mund të funksionojnë virtualisht pa cënuar cilësinë e shërbimit			
<i>Shërbimi shëndetësor duhet të vazhdojë:</i>			
▪ 100% online	12	7	0
▪ më së shumti online, vetëm rastet e domosdoshme in-person.	27	19	14
▪ 50% online – 50% in-person	59	61	54
▪ më së shumti in-person, vetëm rastet e domosdoshme online.	1	12	27
▪ 100% in-person	1	1	5
<i>Kategoritë e pacientëve që mund të trajtohen me VHC (sugjerime)</i>			
▪ Të moshuarit > 60 vjeç			
▪ Personat me pamundësi fizike			
▪ Nënata që janë në punë			
<i>Patologjitë që mund të trajtohen me VHC (sugjerime).</i>			
Sëmundje akute:			
▪ Virozat			
▪ të tjera			
Sëmundje kronike:			
▪ Alergjitë			
▪ Astma			
▪ Diabeti (komplikimet)			
▪ Hipertensioni			
▪ Kardiopatitë			
▪ Gastro-enteritet			
▪ Psikiatria			
▪ të tjera			
<i>Simptomat që mund të trajtohen me VHC (sugjerime).</i>			
▪ këshillimi për mirërritjen e fëmijës			
▪ këshillim për vaksinimin			

▪ gjendjet febrile			
▪ mungesa e oreksit			
▪ gjendjet virale të lehta			
▪ dispne			
▪ urtikarje			
▪ diarre, të vjella			
▪ të tjera			
<i>VHC është më efikas</i>			
▪ në vizitën e parë	67	82	52
▪ në monitorimin e gjendjes klinike	91	96	89
▪ mbahen 3 ditë në ndjekje online, nëse situata vazhdon kërkohen në ambulator	97	88	76
<i>Si duhen organizuar vizitat on-line për tu sinkronizuar me vizitat on-site?</i>			
<i>Si duhen raportuar dhe paguar? (sugjerime)</i>			
▪ VHC duhet të regjistrohet dhe të paguhet.			
▪ Të bëhen platforma për ti regjistruar telefonatat dhe ato të paguhet në fund të muajit.			
▪ Duhet paguar plus kur janë jashtë orarit të punës.			
▪ Deri në 11.00 vizita in-person, 11.00-14.00 vizita online.			
▪ Vizita online 24 / 24.			
▪ Të prenotohen vizitat e të sëmurëve kronikë			
▪ Të prenotohen vizitat e rasteve akute			
<i>Me kë do të donit të komunikoni më tepër online: me mjekun apo me infermierin?</i>			
▪ me mjekun	-	-	35
▪ me infermierin	-	-	42
▪ njësoj me të dy	-	-	23

Diskutim

Ky studim nxorri në pah problematikat dhe perspektivën e VCH si nga ofruesit e këtij shërbimi: personeli mjekësor dhe infermieror, si nga përfituesit e tij: pacientët dhe prindërit e fëmijëve.

Nga ana e personelit shëndetësor, theksohej vazhdimisht fakti që nëse vazhdon të përdoret ky shërbim ka nevojë të mirëorganizohet, ndaj edhe platforma digitale e propozuar prej grupit të punës u konsiderua mëse e përshtatshme, sepse nëpërmjet saj mundësohet alternimi i punës në klinikë me komunikimin online me pacientët në një kohë të përshtatshme. Tendenca e pacientëve ishte që të kishin mundësi të komunikojnë me personelin menjëherë, në çdo kohë të ditës, por binin dakort që kjo nuk ishte e realizueshme gjithmonë.

Të dy problemet e paadresuara deri më sot në VHC: formalizimi i shërbimit dhe përlllogaritja e kostos propozohet të adresohen nëpërmjet ofrimit të shërbimit shëndetësor online me anë të një platforme digitale të VHC për Shërbimin Parësor, nëpërmjet së cilës pacientët do të jenë në gjendje të prenotojnë komunikimin për problemin e tyre shëndetësor. Më efikase do të ishte nëse komunikimi i parë do të kryhej nga infermieri i familjes, i cili do të bënte triazhimin e problemit shëndetësor dhe do të caktonte orarin për komunikimin me mjekun. Kjo do ti jepte përgjigje të shpejtë pacientit, do të reduktonte frustrimin e pritjes dhe do të koordinonte më mirë kohën e punës së mjekut. Kjo platformë do të realizonte regjistrimin dhe dokumentimin e komunikimit mjek-pacient, gjë që mundëson formalizimin e punës online dhe llogaritjen e kostos ekonomike të saj. Formalizimi dhe vlerësimi financiar i shërbimit VHC është ndër sfidat e momentit të mjekësisë në nivel global^(13,14) dhe shumë shpejt edhe shërbimi shëndetësor shqiptar do të integrojë dhe standartizojë këtë shërbim.

Konkluzione dhe rekomandime:

Shërbimi shëndetësor virtual duhet të vazhdojë edhe pas kalimit të pandemisë, së paku në dy komponente: triazhimin e vlerësimit të parë të pacientit dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore në vazhdimësi. Komunikimi online në këto dy faza të shërbimit do ti ndihmonte pacientët të ndiheshin më tepër në vëmendje të shërbimit shëndetësor. Preferenca prej pacientit për marrjen e të dyja këtyre shërbimeve është infermieri, jo mjeku.

Financimi: Ky kërkim është financuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI), Tiranë, Shqipëri, një institucion ligjor publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri. në kuadër të programit të Projekteve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH).

Referenca:

1. Meg Barron, Vimal Mishra, Stacy Lloyd, Jared Augenstein (2021). *How to Measure the Value of Virtual Health Care*. Available at <https://hbr.org/2021/06/how-to-measure-the-value-of-virtual-health-care>.
2. Dr. Ami Parekh (2021) *5 virtual health care trends driving employers' health care strategies*. Available at: <https://www.benefitspro.com/2021/01/20/5-virtual-health-care-trends-driving-employers-health-care-strategies/?slreturn=20220006151350>.
3. Carolyn M. Clancy, MD Susan Kirsh, MD, MPH (2021). *Virtual Care and the Pandemic: Are We Reaching All Patients? Annals of Internal Medicine*. Online ISSN: 1539-3704. <https://doi.org/10.7326/M20-5593>
4. Omar Mansour, Matthew Tajanlangit, James Heyward (2021). *Telemedicine and Office-Based Care for Behavioral and Psychiatric Conditions During the COVID-19 Pandemic in the United States. Annals of Internal Medicine*. Online ISSN: 1539-3704. <https://doi.org/10.7326/M20-6243>
5. Christopher S. Russi, Heather A. Heaton, Bart M. Demaerschalk (2020) *Emergency Medicine Telehealth for COVID-19: Minimize Front-Line Provider Exposure and Conserve Personal Protective Equipment*. Mayo clinic proceedings: Perspective and controversy| volume 95, issue 10, p2065-2068, october 2020. <https://doi.org/10.1016/j.mayocp.2020.07.025>.
6. Grigsby J, Kaehny MM, Sandberg EJ, Schlenker RE, Shaughnessy PW. (1995) *Effects and effectiveness of telemedicine*. Health Care Financ Rev. 1995 Fall;17(1):115-31. PMID: 10153466; PMCID: PMC4193577.
7. Eberly LA, Kallan MJ, Julien HM, et al. (2020) *Patient Characteristics Associated With Telemedicine Access for Primary and Specialty Ambulatory Care During the COVID-19 Pandemic. JAMA Netw Open*. 2020;3(12):e2031640. doi:10.1001/jamanetworkopen.2020.31640.
8. Gerhardt CA, Foels R, Grewe S, Baldwin BT. (2021) *Assessing the Diagnostic Accuracy of Teledermatology Consultations at a Local Veterans Affairs Dermatology Clinic*. Cureus. 2021 Jun 2;13(6):e15406. doi: 10.7759/cureus.15406. PMID: 34249554; PMCID: PMC8253700.
9. Jordan Albritton (2022). Video Teleconferencing for Disease Prevention, Diagnosis, and Treatment. *Annals of Internal Medicine*. Online ISSN: 1539-3704. <https://doi.org/10.7326/M21-3511>.
10. Reed M, Huang J, Graetz I, Muelly E, Millman A, Lee C. (2021) *Treatment and Follow-up Care Associated With Patient-Scheduled Primary Care Telemedicine and In-Person Visits in a Large Integrated Health System. JAMA Netw Open*. 2021 Nov 1;4(11):e2132793. doi: 10.1001/jamanetworkopen.2021.32793. PMID: 34783828; PMCID: PMC8596201.

11. The Manufacturers Life Insurance Company. (2021) *Virtual healthcare trends - Is virtual healthcare the way of the future?* available at <https://www.coverme.com/blog/health/is-virtual-healthcare-trends.html?province.=ON&agecode=0>
12. Wellbox (2021) *4 Ways Virtual Care Trends are Impacting Healthcare*. Available at: <https://wellbox.care/virtual-care-trends-impacting-healthcare/>.
13. Care Innovations, LLC (2022) *How Virtual Care Benefits Patients, Clinicians & Healthcare Organization*. available at <https://news.careinnovations.com/blog/how-virtual-care-benefits-patients-clinicians-healthcare-organizations>.
14. Healthline Media a Red Ventures Company. (2022) *How Does Telemedicine Work, and What Are the Benefits?* available at <https://www.healthline.com/health/healthcare-provider/telemedicine-benefits>.

PLATFORMA DIGITALE E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR PARËSOR

Ismail Bitraj, Aurela Saliqaj, Ina Islamaj, Enkelejd Mëhilli.

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit
Drejtoria Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë
Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Abstrakt

Qëllimi: Prezantimi i një platforme digjtale për shërbimin shëndetësor parësor.

Metodologjia: Ky studim është zhvilluar në kuadër të programit të AKKSHI për Projekte Kombëtare të Kërkim Zhvillimit 2021. Studimi është kryer në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë dhe ka përfshirë personelin mjekësor dhe pacientët e Shërbimit Parësor në Rajonin e Vlorës. Platforma e disenjuar nga grupi i punës së projektit është prezantuar tek personeli shëndetësor dhe pacientët e intervistuar.

Rezultatet: Në total janë intervistuar 31 mjekë pediatër, 28 mjekë për adultët, 33 infermiere pediatre, 45 infermiere adulti, 35 pacientë dhe 27 prindër fëmijësh nga 52 qendra shëndetësore në tre qarqe: Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë.

Elementët që duhet të përfshijë një platformë teknologjike në funksion të shërbimit shëndetësor virtual u rekomanduan të jenë: Gjeneralitetet e pacientit, Historiku i pacientit: vizitat, klinika, analizat, trajtimet sipas datës kur janë kryer, Anamneza familjare, Diagnozatat e pacientit, Ekzaminimet e kryera, Mjekimet e marra, Monitorimi i ecurisë së pacientit, Prenotimi i vizitës online me mjekun / infermierin e familjes, Prenotimi i vizitës me specialistin, Rregjistrimi i vizitës: audio – video – mesazhe, Konstatimet e vizitës online, Kërkesat për ekzaminime laboratorike, radiologjike etj, Rezultatet e ekzaminimeve, Receta / Rekomandimet e mjekut-infermierit, FAQ.

Konkluzionet: Platforma digjtale, e propozuar nga grupi i punës së projektit, do të rriste efikasitetin e komunikimit online me pacientin dhe do të formalizonte dokumentimin e shërbimit shëndetësor virtual.

Fjalët kyçe: platforma digjtale, shërbimi shëndetësor virtual, pandemia Covid-19.

PRIMARY HEALTHCARE DIGITAL PLATFORM

Ismail Bitraj, Aurela Saliqaj, Ina Islamaj, Enkelejd Mëhilli.

University 'Ismail Qemali' of Vlora, Faculty of Health
The Regional Directorate of the Health Care Services Operator of Vlora
National Agency for Scientific Research and Innovation

Aim

Introducing a digital platform for primary health care.

Methodology

This study was developed within the AKKSHI program for National Research and Development Projects 2021. The study was carried out in cooperation with the Regional

Directorate of the Vlora Health Care Services Operator and included the medical staff and patients of the Primary Service in the Vlora Region. . The platform designed by the project's working group has been presented to health personnel and interviewed patients.

Results

In total, 31 pediatricians, 28 adult doctors, 33 pediatric nurses, 45 adult nurses, 35 patients and 27 parents of children from 52 health centers in three counties were interviewed: Vlorë, Fier and Gjirokastrë.

The elements that should include a technological platform in the function of the virtual health service were recommended to be: Generalities of the patient, History of the patient: visits, clinics, tests, treatments according to the date when they were performed, Family history, Diagnoses of the patient, Examinations performed , Medications received, Monitoring of the patient's progress, Online visit booking with the family doctor / nurse, Specialist visit booking, Visit recording: audio - video - messages, Online visit findings, Requests for laboratory, radiological examinations, etc. , Results of examinations, Prescriptions / Recommendations of the doctor-nurse, FAQ.

Conclusions

The digital platform, proposed by the project working group, would increase the efficiency of online communication with the patient and formalize the documentation of the virtual health service.

Keywords

digital platform, virtual health service, Covid-19 pandemic.

E-HEALTH

Sistemi i Menaxhimit të Kartelave Mjekësore

Platforma E-HEALTH është një web aplikacion online për spitalin i cili menaxhon mjekët dhe pacientët. Në këtë projekt, ne përdorim bazën e të dhënave PHP dhe MySQL.

E gjithë platforma përbëhet kryesisht nga 3 module, të cilat janë:

- Moduli i administratorit
- Moduli i mjekut
- Moduli i përdoruesit (pacientët)

Objektivi është krijimi i një sistemi kompjuterik "E-Health"(Sistemi i menaxhimit të kartelave Mjekësore) që të automatizojë procedurat të cilat bëhen në mënyre manuale si janë: regjistrimi i pacientëve, caktimi i takimeve etj. Në sistem janë të përfshirë module për menxhimin e doktorëve, pacientëve, stafin e shërbimit shëndetësor si dhe moduli i administratorit të sistemit kompjuterik.

- Krijimi i një modeli të ri shëndetësor që është më afër qytetarëve
- Qasja e pacientëve në shërbimet shëndetësore
- Të inkurajojë shkëmbimin e të dhënave me objekte të tjera të lidhura, të quajtur objekte inteligjente (pajisjet e veshjes)
- Ofrimi i kujdesi në zona të largëta, përmirësimin e vazhdimësisë së kujdesit përmes sistemeve të menaxhimit të marrëdhënieve me pacientët, dhe mbështetjes së shërbimeve të urgjencës.

- Përmirësimi i marrëdhënieve mes pacientit dhe personelit shëndetësor, duke zgjeruar ndërveprimin mes tyre.

Aspektet kryesore që ka ripërcaktuar shëndeti dixhital janë:

- Mundësia që konsumatorët të ndërveprojnë online me sistemet e tyre;
- Përmirësimi i transmetimit të të dhënave nga institucioni në institucion;
- Shfaqja e mundësive të reja për konsumatorët për të komunikuar peer-to-peer, ndërmjet tyre.

Arkitektura e sistemit

- E-Health është një aplikacion mobile ready i bazuar në teknologjitë web. Teknologjia e aplikuar është LAMP (Linux, Apache, MYSQL, PHP). Struktura është MVC (Model View Controller).
- Projekti E-HEALTH përfshin regjistrimin e të dhënave të pacientëve, ruajtjen e tyre në sistemin si dhe përpunimin e tyre nga persona të autorizuar. Softueri ka mundësinë të japë një ID unike për çdo pacient dhe ruan detajet e çdo pacienti në një bazë të dhënash.
- E-HEALTH u vjen në ndihmë si përdoruesve të spitalve, klinikave mjekësore, por edhe pacientëve të tyre të cilët mund të shohin në kohë reale kartelën e tyre të marrin njoftime të ndryshme dhe të mund të rezervojnë takimin e radhës.



Platforma digitale e Shërbimit Shëndetësor Virtual (shërbimi parësor)

Elementët përbërës të aplikacionit (vizitë online + kartelë mjekësore elektronike):

- Kartela e pacientit
 - Gjeneralitetet e pacientit
 - Historiku i pacientit: vizitat, klinika, analizat, trajtimet sipas datës kur janë kryer.
 - Anamneza familjare
 - Diagnozat e pacientit
 - Ekzaminimet e kryera
 - Mjekimet e marra
 - Monitorimi i ecursisë së pacientit
- Prenotimi i vizitës online me mjekun / infermierin e familjes (prenotohet prej pacientit në oraret e disponueshme online të mjekut/infermierit të familjes)
- Prenotimi i vizitës me specialistin (prenotohet nga mjeku i familjes për pacientin)
- Rregjistrimi i vizitës: audio – video – mesazhe
- Konstatimet e vizitës online (prej mjekut / infermierit)
- Kërkesat për ekzaminime laboratorike, radiologjike etj.(prej mjekut)
- Rezultatet e ekzaminimeve (prej laborantit)
- Receta / Rekomandimet e mjekut-infermierit (prej mjekut / infermierit)
- FAQ

Vizita le gjurmë në sistemin digital dhe faturohet sipas specifikës që ka: orarit, kohëzgjatjes, llojit të sëmundjes.

Vizita rregjistrohet si në Kartelën e Pacientit, si në Dosjen e Mjekut.

Diagrama e aktivitetit të përdoruesit**(Patient)****Paneli Përdorues****Referencat:**

1. Jordan Albritton (2022). Video Teleconferencing for Disease Prevention, Diagnosis, and Treatment. *Annals of Internal Medicine*. Online ISSN: 1539-3704. <https://doi.org/10.7326/M21-3511>.
2. Reed M, Huang J, Graetz I, Muelly E, Millman A, Lee C. (2021) *Treatment and Follow-up Care Associated With Patient-Scheduled Primary Care Telemedicine and In-Person Visits in a Large Integrated Health System*. JAMA Netw Open. 2021 Nov 1;4(11):e2132793. doi: 10.1001/jamanetworkopen.2021.32793. PMID: 34783828; PMCID: PMC8596201.
3. The Manufacturers Life Insurance Company. (2021) *Virtual healthcare trends - Is virtual healthcare the way of the future?* available at <https://www.coverme.com/blog/health/is-virtual-healthcare-trends.html?province.=ON&agecode=0>
4. Wellbox (2021) *4 Ways Virtual Care Trends are Impacting Healthcare*. Available at: <https://wellbox.care/virtual-care-trends-impacting-healthcare/>.
5. Care Innovations, LLC (2022) *How Virtual Care Benefits Patients, Clinicians & Healthcare Organization*. available at <https://news.careinnovations.com/blog/how-virtual-care-benefits-patients-clinicians-healthcare-organizations>.
6. Healthline Media a Red Ventures Company. (2022) *How Does Telemedicine Work, and What Are the Benefits?* available at <https://www.healthline.com/health/healthcare-provider/telemedicine-benefits>.

EFEKTET ANËSORE TË VAKSINËS COVID-19 NË POPULLATËN E VLORËS DHE PERCEPTIMET E TYRE MBI DOZAT PASARDHËSE

Dr. Majlinda Zahaj, Prof Asoc Enkelejd Mëhilli, Prof Asoc Aurela Saliqaj, PhDc Vasilika Prifti, PhDc Sonila Nika, Dr. Evis Allushi, Dr. Denada Selfo, Msc Inis Hoxhaj, Mateo Alushi

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit
Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Abstrakt

Hyrje: Vaksinimi kundër COVID-19 ka ndryshuar ndjeshëm rrjedhën e pandemisë, duke shpëtuar dhjetëra miliona jetë globalisht dhe dozat përforcuese janë thelbësore në rivendosjen e efektivitetit të vaksinës, veçanërisht për popullatat e cenueshme. Procesi i vaksinimit në Shqipëri ka qenë i gjatë dhe sfidues, i mbushur me paqartësi nga grupe të ndryshme njerëzish. *Ky studim synonte të vlerësonte* gatishmërinë dhe mundësitë/barrierat që mund të ndikojnë në procesin e vaksinimit me dozën përforcuese.

Metodologjia: Ky është një studim ndërseksional i kryer në qytetin e Vlorës, Shqipëri. Dy qendra vaksinimi u zgjodhën në mënyrë të rastësishme si mostra grupore. Personat që u vaksinuan në këto qendra fillimisht u intervistuan personalisht për perceptimin e tyre për procesin e imunizimit dhe më pas u kontaktuan me telefon një muaj më vonë për t'u pyetur për efektet anësore dhe ndikimin e vaksinës në sëmundjet e tyre kronike. Pas një viti, një mostër tjetër u intervistua për vazhdimësinë e vaksinimit, me dozën e tretë dhe të katërt si dhe arsye mbi vazhdimin ose jo të dozave të tjera.

Rezultatet: Hulumtimi aktual tregoi se prevalenca e vazhdimin të procesit të vaksinimit ishte 82%. Infeksioni Covid-19 duket se reduktohet ndjeshëm pas çdo doze vaksinimi. Dhimbja në vendin e injektimit (86.4%), dhimbje muskulore (8.5%), lodhje (6.3%), dhimbje koke (4%), ethe (2.8%) dhe simptoma të tjera (10%) ishin efektet anësore më të raportuara të vaksinave. Mostra e dytë e pjesëmarrësve (N=311), 38% (N=117) morën dozën e tretë dhe vetëm 8.1 % (N=25) morën dozën e katërt. 66% e pjesëmarrësve deklaruan se nuk do të merrnin dozën e tretë dhe të katërt të vaksinave nëse do të kishin më shumë informacion. Pothuajse 40% mendojnë se vaksinat përkeqësojnë gjendjen e tyre shëndetësore.

Konkluzione: Pavarësisht nga efektet anësore dhe prania e sëmundjeve kronike, shumica e individëve janë të gatshëm të vazhdojnë procesin e vaksinimit deri në dozën e dytë. Ky vendim duket se ndikohet ndjeshëm nga efektiviteti i vaksinimit në parandalimin e infeksionit COVID-19, lloji i vaksinës së administruar dhe perceptimi se ashpërsia e efekteve anësore zvogëlohet në dozat përforcuese. Procesi i vaksinimit në Vlorë, Shqipëri duket se ka një shkallë të lartë pranimit për dozën e parë dhe të dytë, por normat ishin shumë më të ulëta për dozën e tretë dhe të katërt. Ky studim zbuloi se pjesëmarrësit vendosën të merrnin doza të tjera në varësi të ashpërsisë së efekteve anësore të mëparshme të përjetuara dhe nivelit të mbrojtjes nga infeksioni COVID-19.

Tendencat e njerëzve për nxitësit e vaksinave kanë ndryshuar brenda një periudhe njëvjeçare. Shkalla e vaksinimit të dozave të treta dhe të katërta është shumë më e ulët. Njerëzit mendojnë se këto doza nuk i mbrojnë më nga infeksioni COVID dhe kanë efekt negativ në sëmundjen e tyre aktuale.

Fjalë kyçe: vaksinat kundër COVID-19; dozë përforcuese; efekte anësore, sfida

SIDE EFFECTS OF COVID-19 VACCINES IN THE POPULATION OF VLORE AND THEIR PERCEPTIONS ABOUT OTHER DOSES

Dr. Majlinda Zahaj, Prof Asoc Enkelejd Mehilli, Prof Asoc Aurela Saliaj, PhDc Vasilika Prifti, PhDc Sonila Nika, Dr. Evis Allushi, Dr. Denada Selfo, Msc Inis Hoxhaj, Mateo Alushi

University 'Ismail Qemali' of Vlora, Faculty of Health
National Agency for Scientific Research and Innovation

Introduction

Vaccination against COVID-19 has significantly changed the course of the pandemic, saving tens of millions of lives globally, and booster doses are essential in restoring vaccine effectiveness, especially for vulnerable populations. The vaccination process in Albania has been long and challenging, filled with ambiguity from different groups of people. This study aimed to assess readiness and enablers/barriers that may influence the booster vaccination process.

Method

This is a cross-sectional study conducted in Vlore during May – July 2021. The study included 306 individuals who answered a three-part questionnaire (24 questions in total) on COVID infection, types of vaccines, side effects and intentions to get the second doses. The data were analysed using the IBM SPSS-21 package.

Results

91.8 % of the individuals were infected with COVID before vaccination, while 8.2% after vaccination. 86.4% were infected after the first dose and 13.6% after the second dose. Pain in the injection site (67.4%), muscle pain (8.5%), tiredness (6.3%), headache (4%), fever (2.8%) and other symptoms (10%) were the most reported side effects of the vaccines. 82% (n=251) had the second dose of the vaccine done, and 18% (n=55) not. A statistical significance between the type of vaccine and decision to get the second dose was found. Type of vaccine and the organ system effected were related when individuals were infected with COVID-19 ($p=0.045$); vaccines and symptoms ($P=0.069$), especially the second dose; individuals vaccinated with Astra Zeneca had less symptoms ($p<0.001$).

Conclusions

Side effects after vaccination were mild for most of participants. These symptoms affected individuals' decision to get vaccinated. Regardless of side effects and chronic diseases people think to have second doses. Gender, socio-economic status, education level didn't affect decision to get vaccinated. Vaccines lowered the number of individuals getting infected.

Key words

COVID, vaccines, vaccinated individuals, side effects, second dose

Hyrje

Pandemia e COVID-19 që filloi në fund të vitit 2019 në Wuhan të Kinës, e shtyu komunitetin mjekësor dhe farmaceutik të mendonte shpejt për zhvillimin e mënyrave të reja për të luftuar infeksionin vdekjeprurës. Vaksinat e reja u zhvilluan nga kompani të ndryshme, por efektiviteti i tyre dhe efektet anësore të mundshme në fazat fillestare ishin të panjohura. Sipas Abdalla M, (2022) procesi i imunizimit filloi në vende të ndryshme duke paraqitur sfida

të veçanta duke filluar nga besueshmëria e vaksinave për shkak të miratimit të shpejtë të tyre, deri te përdorimi i tyre dhe dilema e ngjarjeve shëndetësore pas vaksinimit. Që nga dhjetori 2020, pesë (5) vaksina u miratuan nga FDA dhe EMA. Ato ishin Pfizer- BioNTech, Moderna, Janssen, Novavax COVID-19 Vaccine, Adjuvanted dhe Astra Zeneca (Vaxzevria) (FDA, 2022). Pas marrjes së miratimit të Administratës Amerikane të Ushqimit dhe Barnave (FDA) më 23 gusht 2021, vaksina Pfizer- BioNTech COVID-19 u miratua gjithashtu për të rinjtë e moshës 16 vjeç e lart dhe filloi të tregtohet nën emrin e markës COMIRNATY (Shimabukuro, 2021 Rosenblum et.al., 2022); në shkurt 2021 vaksina u miratua me emrin AstraZeneca/Oxford COVID-19 e cila u quajt Vaxzevria më vonë në Mars 2021 (Agjencia Rregullatore e Produkteve të Mjekësisë dhe Kujdesit Shëndetësor, 2020); SKBio dhe Ad26.CO2 u miratuan për përdorim në mars 2021 (Komiteti Këshillimor i FDA-së shkurt 2022), vaksina Janssen në shkurt 2021, vaksina Moderna (Spikevax) në janar 2022 (FDA Shkurt, 2022). Në të gjithë botën kishte rreth 50 vaksina të miratuara për përdorim urgjent, nën prova klinike në vende të ndryshme, por vetëm njëmbëdhjetë (11) u miratuan nga OBSH për t'u përdorur në vendet evropiane (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2022).

Vaksinat e disponueshme për COVID-19 janë të sigurta dhe efektive dhe mbrojnë individët që të mos sëmuren rëndë, parandalojnë shtrimin në spital dhe parandalojnë vdekjen (Xu et.al., 2023). EMA ka mbledhur një sasi të madhe të dhënash nga provat klinike në të gjitha pjesët e botës për të siguruar që vaksinat e COVID-19 janë të sigurta dhe efektive. Dozat përforcuese duhet të konsiderohen si synime për shëndetin publik në mënyrë që të merren rezultate efektive të procesit të vaksinimit (Ssentongo et.al., 2022; Qendra Kombëtare për Imunizimin dhe Sëmundjet e Frymëmarrjes, 2020). Për të minimizuar infeksionin SARS-CoV-2, popullatat në rrezik duhet të synohen në përpjekjet për doza përforcuese, duke ulur ndjekjet e infeksionit dhe komplikimeve, veçanërisht pacientët me sëmundje kronike Rudan et.al., 2021; Antonelli etj. al., 2022). Shkalla e pranimi global të vaksinës përforcuese të COVID-19 është e lartë, por normat ndryshojnë sipas rajonit dhe vendit duke ngritur çështje kritike për barazinë (Sëmundjet TL, 2021). Disa faktorë u treguan se lidhen me pranimin më të ulët të vaksinimit kundër COVID-19, duke përfshirë karakteristikat socio-demografike dhe faktorët psikologjikë, duke përfshirë besimin e ulët në sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës; vetëkënaqësi e lartë e manifestuar në një perceptim më të lartë të rreziqeve të sëmundjes; komoditet i ulët për sa i përket aksesit në shërbimet e vaksinimit; llogaritje e lartë e përfitimeve dhe rreziqeve të vaksinimit; përgjegjësi e ulët kolektive e nevojshme për të mbrojtur grupet vulnerabël në shoqëri; dhe përqaftim i lartë i besimeve konspirative të vaksinave si përkeqësimi i sëmundjes aktuale, duke shkaktuar probleme të reja shëndetësore dhe shumë të tjera (Abdelmoneim, 2022; Fajar, 2022; Abdou, 2021; Sallam, 2021; Moghadas, 2021).

Studime nga Dagnaw Baye 2022 dhe Oliver J Watson, 2022 kanë arritur në përfundimin se vaksinat janë të sigurta dhe efikase, me efekte anësore të vogla pas dozave të aplikuara si dhimbje në vendin e injektimit, lodhje, dhimbje koke, dhimbje muskulore, ethe etj., ka disa keqkuptime që Vetë vaksinat mund të shkaktojnë sëmundjen COVID-19 ose probleme të tjera shëndetësore që u atribuohen atyre, të tilla si trombozat, problemet e zemrës dhe mushkërive, krijimi i varianteve të reja të COVID-19, vaksinat përmbajnë mikroçipe, ato mund të ndryshojnë ADN-në e njeriut etj., përfundoi nga Zakar 2022 dhe Hervé në 2019. Disa simptoma janë përshkruar si efekte anësore të vaksinave COVID-19. Ndër disa studime, Dar-Odeh në vitin 2022 në një studim në Arabinë Jugore raportoi se lodhja, shqetësimet menstruale, mialgjia, artralgjia, marramendja dhe dhimbja e kokës si efekte anësore më të shpeshta.

Menni et.al., 2021 dhe Menni et.al., 2022 raportuan se efektet anësore sistematike dhe lokale ishin më të zakonshme tek individët me infeksion të mëparshëm SARS-CoV-2 sesa tek ata pa infeksion të njohur të së kaluarës. Për më tepër, ashpërsia e efekteve anësore dhe periudha kohore e pranisë së tyre ndryshojnë nga një person në tjetrin, por ato pakësohen pas çdo doze dhe krijojnë imunitet ndaj infeksionit COVID-19.

Situata shqiptare e vaksinimit

Pas procesit të imunizimit në botë, imunizimi në Shqipëri filloi në janar 2021. Kjo fillimisht u bë në bazë të donacioneve nga pak vende të BE-së me vaksinat Pfizer, AstraZeneca, Sinovax dhe Sputnik. Në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë u krijuan qendra të mëdha vaksinimi të drejtuara nga personeli i shëndetit publik, të trajnuar për procesin e vaksinimit, trajtimin dhe ruajtjen e vaksinave, zinxhirin e ftohjes dhe të gjitha çështjet e regjistrimit të të dhënave të individëve të vaksinuar. Në datën 8 janar ²⁰²³, sipas faqes në internet të GITHUB, të dhënat për Shqipërinë tregojnë se 47.6% e popullsisë ka marrë të paktën një dozë, dhe vetëm 45% janë të vaksinuar plotësisht (tre doza), me një total prej 3.042.696. dozat e vaksinës .

Qyteti i Vlorës ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë dhe është qyteti i tretë më i madh, me një popullsi prej 187,675 banorësh. Procesi i vaksinimit në këtë qytet ka nisur në prill të vitit 2021 me fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe donacionet nga vendet evropiane, që është një nga arsyt kryesore që qytetarët nuk kanë mundur të zgjedhin llojin e vaksinave të aplikuara ndaj tyre . Qeveria në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore vendase krijuan pesë qendra vaksinimi në qytetin e Vlorës , ku të gjithë qytetarët mund të vinin lirisht dhe të vaksinoheshin pasi të regjistroheshin te mjeku i familjes. Shtypi vendor dhe kombëtar dhe zyra e mjekëve të familjes rekomanduan me forcë vaksinimin për të gjithë qytetarët, veçanërisht ata që vuanin nga sëmundje kronike. Në qarkun e Vlorës nuk ka studime të detajuara për efektet anësore të vaksinave apo prirjen e popullsisë në procesin e vaksinimit. Në kohën e procesit të vaksinimit kishte një vështirësi të madhe për t'iu afruar njerëzve pasi të gjithë kishin frikë të ishin fizikisht afër njerëzve të tjerë. Edhe personeli shëndetësor e kishte të vështirë t'u afrohej njerëzve në qendrat e vaksinimit për t'i pyetur për gjendjen shëndetësore apo çështje të tjera shëndetësore. Studimi aktual synon të vlerësojë perceptimin për procesin e vaksinimit dhe faktorët që lidhen me të. Ky studim është shumë i rëndësishëm për të kuptuar perceptimet e qytetarëve vlonjatë në kohën specifike të periudhës së kryerjes, duke evidentuar situatën e vaksinimit të asaj periudhe kohore.

Metodat

Përcaktimi dhe studimi i popullsisë

Ky është një studim ndërseksional i kryer në qytetin e Vlorës , Shqipëri. Për të kryer studimin, pjesëmarrësit u drejtuan në dy qendra vaksinimi të cilat u zgjodhën në mënyrë të rastësishme si mostra grupore. Në kohën e studimit, në qytetin e Vlorës kishte pesë qendra vaksinimi në total . Këto qendra vaksinimi u krijuan nga Ministria e Shëndetësisë në zona të mëdha larg zonës së populluar për të mos krijuar turma të mëdha njerëzish. Në këtë periudhë kohore të gjithë të rriturit shqiptarë kishin të drejtë për vaksinim, por prioritet kishin të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. Kushdo që donte të vaksinohet shkonte në qendrat e vaksinimit me një dokument identifikimi dhe rrinte në radhë, merrte informacion për vaksinën që kishte dhe plotësonte punimet e kërkuara në letër. Ne kontaktuam personat që erdhën për t'u vaksinuar në këto dy qendra gjatë periudhës maj-korrik 2021 dhe u kërkuam të merrnin pjesë në këtë hulumtim, pasi sqaruam me kujdes qëllimin e këtij studimi, duke siguruar anonimitetin e të dhënave të tyre. Nga 352 persona që u vaksinuan në dy qendra gjatë kësaj periudhe, 306 prej tyre pranuan të intervistoheshin kur iu kërkuar të ishin pjesë e studimit si dhe pranuan të telefonoheshin pas një muaji.

Pjesa e dytë e studimit u krye gjatë periudhës kohore shtator 2022-maj 2023. Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar të njëjtën intervistë me individë të disa qendrave të kujdesit shëndetësor në qytetin e Vlorës. Këtë herë ata iu përgjigjën të njëjtave pyetje për dozën e tretë dhe të katërt të vaksinave të aplikuara.

Mbledhja e të dhënave

Procesi i intervistimit mori pjesë brenda qendrave të vaksinimit, duke iu afruar individëve pasi kishin marrë vaksinën dhe prisnin rreth zonës së caktuar për periudhën e kontrollit. Ndërsa grupi i dytë i individëve u drejtuan në qendrat shëndetësore të qytetit dhe iu drejtuan të njëjtat pyetje.

Intervistuesit ishin tre studentë dhe dy infermierë, të cilët ishin të njohur me pyetjet e instrumentit, dhe ishin trajnuar nga ekipi hulumtues për të respektuar privatësinë, masat kundër COVID dhe dinin të regjistronin përgjigjet. Trajnimi i intervistave është bërë nga hetuesi parësor i studimit. Të gjithë ata morën të njëjtin informacion dhe trajnim. Procedura e trajnimit zgjati 4 orë. Individët fillimisht janë intervistuar personalisht brenda qendrave të vaksinimit dhe më pas janë kontaktuar me telefon një muaj më vonë për t'u pyetur për efektet anësore dhe mendimin e tyre për ndikimin e vaksinës në sëmundjet e tyre kronike. Të gjithë pjesëmarrësit e intervistuar ranë dakord të merrnin telefonata një muaj pas intervistës fillestare dhe në të vërtetë të gjithë u përgjigjën herën e dytë.

Instrumenti i Kërkimit

Për të mbledhur të dhënat për studimin, ne zhvilluam një intervistë të strukturuar, bazuar në një pyetësor të përbërë nga pyetje të mbyllura. Fillimisht versioni i parë i pyetësorit u përpilua nga dy anëtarë të grupit kërkimor pas një rishikimi të gjerë të literaturës së disponueshme në atë periudhë. Para përdorimit të instrumentit, tre ekspertë të fushës dhanë komente/sugjerime. Pas pilotimit të pyetësorit, korrigjimit dhe përshtatjes së versionit përfundimtar, pyetësi përfundimtar përbëhet nga 24 pyetje. Versioni përfundimtar u përmbledh duke e shpërndarë atë te 45 individë të përzgjedhur rastësisht në një nga qendrat e vaksinimit të zgjedhura për të mos qenë pjesë e procesit të përzgjedhjes së grupit të mostrës. Pas korrigjimeve eventuale, pyetësi u testua për besueshmërinë e brendshme dhe u arrit vlera e koeficientit Cronbach alfa prej 0,968.

Pyetjet e instrumentit përbëhen në dy pjesë: pjesa e parë përfshin pyetje mbi të dhënat demografike të pjesëmarrësve (mosha, gjinia, vendbanimi, statusi arsimor, punësimi dhe prania e sëmundjeve kronike). Pjesa e dytë përfshin anamnezat mjekësore të COVID-19, statusin e vaksinimit (doza e parë ose e dytë e vaksinave dhe llojet), pyetjet mbi kushtet shëndetësore pas vaksinimit, efektet anësore pas çdo doze vaksinimi, trajtimin e efekteve negative dhe opinionin nëse vakcina ose infeksioni COVID ka prekur sëmundjet kronike të pjesëmarrësve.

Analiza statistikore

Të dhënat u analizuan duke përdorur paketën statistikore IBM SPSS-21. Të dhënat cilësore të mbledhura paraqiten si numra dhe përqindje absolute ndërsa variacionet sasiore paraqiten si mesatare dhe devijim standard. Kemi kryer analiza univariante dhe bivariate. Niveli i rëndësisë u vendos në nivelin 0.10 dhe të gjitha testet ishin të dyanshme.

Çështje etike

Të gjitha çështjet etike janë respektuar dhe ndjekur në mënyrë rigoroze nga autorët. Pjesëmarrja ishte konsensuale dhe pjesëmarrësit mund të ndalonin në çdo moment konkurrimin e pyetësorit. Asnjë të dhënë personale nuk u regjistrua ndërsa të gjitha të dhënat e tjera të mbledhura u përdorën vetëm për qëllimin e studimit aktual. Studimi është miratuar nga Fakulteti i Shëndetit nr. 1500/1 miratuar më 30 prill 2021.

Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe pjesëmarrësit mund të tërhiqeshin nga studimi në çdo moment. Për më tepër, ata ishin të lirë të mos e ndiqnin intervistën telefonike ose të ndalonin bisedën telefonike në asnjë moment.

Rezultatet

Popullata përfundimtare e studimit ishte 306 individë nga 352 persona të cilët ishin vaksinuar në periudhën kohore të kërkimit (shkalla e pranimi =86,95) në dy qendrat e përzgjedhura gjatë periudhës së kërkimit. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 53.03 (SD

During the period December 2022 - April 2023, through a cross-sectional study, all children of state nurseries in the city of Vlora and children of 41 state kindergartens in this region were screened for psycho-motor development with the ASQ-3 test and for socio-emotional development with the ASQ-SE 2 test. With these data, a children's development database has been created, which is administered by the Research-Scientific Center of Health Policy and which will be continuously updated in Data Repository of the University of Vlora.

Results

The average level of development, measured with the ASQ-3 test, among preschool children registered in daycare centers in the city of Vlora is satisfactory (226.5 points out of 300 points, according to the ASQ-3 test). Likewise, in the assessment of development levels, the majority of children (68.1%) belong to the middle level (201-250 points). 53.6% of children had at least one sector with slight delay (gray area) or significant one (black area). The psychomotor sector with the lowest level of evaluation was found in the Problem Solving (Reasoning) sector, in which 39.2% of children showed psychomotor delays, while the sector with the highest percentage of serious psychomotor delays was found in the Communication with 6.1% of children assessed in the black area.

Conclusions

Monitoring the psycho-motor development of children up to 6 years old by means of the screening test Age&Stage Questionnaires-3 should be part of the routine follow-up.

Key words

psycho-motor development, psycho-emotional development, preschool education in the city of Vlora.

Zhvillimi psikomotor – një aspekt i rëndësishëm dhe relativisht i neglizhuar e i paeksploruar i zhvillimit shumëplanësh të fëmijës.

Zhvillimi psiko-motor është një prej komponentëve më të rëndësishëm në përcaktimin e mirërritjes dhe mirëzhvillimit të një fëmije, por për fat të keq, në vendin tonë nga ana e prindërve dhe edukatorëve, madje edhe nga ana e personelit mjekësor, ende vlerësohet primare vetëm ndjekja në vazhdimësi e zhvillimit fizik, ndërsa vlerësimi i zhvillimit psiko-motor të fëmijëve parashkollorë është sporadik dhe intuitiv. Fakti i mospërdorimit të një metode shkencore dhe të standartizuar të matjes psikometrike të zhvillimit psiko-motor e bën vlerësimin e tij tek fëmijët akoma më të vagullt e të pasaktë. Kjo bën që të mos arrihet të diagnostikohet një përqindje e madhe zhvillimesh atipike, të cilat bëhen të dukshme e të matshme shumë vonë, kur fëmija ka hyrë tashmë në arsimin fillor.

Çdo vit më tepër se 200 milionë fëmijë nën 5 vjeç dështojnë në arritjen e potencialit të plotë konjitiv dhe social (shumë prej këtyre fëmijëve jetojnë në Azinë jugore dhe në Afrikën sub-sahariane). Si rezultat i zhvillimit të mangët shumë prej këtyre fëmijëve rrezikojnë të mos kenë arritjet e duhura në shkollë, e si rezultat produktivitet të ulët si adultë. Kur bëhen adultë ata kanë tendencë të lindin fëmijët e tyre në moshë shumë të re, duke u siguruar një kujdes shëndetsor, ushqyerje dhe stimulim të pamjaftueshëm, duke kontribuar në këtë mënyrë në transmetimin brez-pas-brezi të varfërisë dhe prapambetjes në zhvillim.

Në 2017 u konstatua që më tepër se 40% e prindërve të fëmijëve 4-5 vjeç në USA raportojnë ≥ 1 shqetësim lidhur me zhvillimin psikomotor të fëmijës së tyre. Sipas raportimeve të ndryshme (Mackrides 2018), 12-16% e fëmijëve në USA kanë të paktën një vonesë zhvillimi, e megjithatë së paku gjysma e fëmijëve me probleme nuk identifikohen që në moshën parashkollore. Në një studim me dy faza (Phoebe&Arthur Williams, 1986) gjatë fazës së parë u konstatua se ndodhitë perinatale janë një faktor risku sinjifikant që influencojnë zhvillimin e fëmijëve të grup-moshës 2 javë deri 6 vjeç. Sektorët me numrin më të madh të vonesave ishin sektorët e Motorikës globale dhe Personal-Social. Shumë detyra në sektorin Personal-Social, të cilat tregojnë aftësinë e fëmijës për tu kujdesur për vetveten, si: pirja me filxhan, larja dhe tharja e duarve, veshja me mbikëqyrje dhe ndarja lehtësisht prej nënës, nuk arrinin të realizoheshin prej fëmijëve.

Në një studim pilot për depistimin e zhvillimit psikomotor nëpërmjet testit ASQ-3 në një popullatë fëmijësh në Oakland County, USA në vitin 2020, të publikuar nga Early Childhood Investment Corporation (www.greatstartforkids.com), u konstatuan 20% e fëmijëve të depistuar në zonën monitoruese dhe 16% në zonën depistuese. 9% e fëmijëve kishin vetëm 1 vonesë psikometrike dhe 7% e tyre dy apo më shumë vonesa. Përsa u përket përqindjes së fëmijëve në zonat referuese sipas sektorëve psikometrikë, ato ishin respektivisht 5%, 8%, 4%, 5% dhe 6%. Pavarësisht këtyre fakteve tronditëse, sektori shëndetsor ka ecur ngadalë në edukimin shëndetsor përsa i përket zhvillimit të hershëm të fëmijës dhe në mbështetjen e familjeve me kapacitete dhe informacione të përshtatshme.

Lehtësia për të detektuar problemet e zhvillimit tek fëmijët, si nga profesionistët e shëndetit, si nga familjarët e fëmijës, mund të varet nga shumë faktorë. Identifikimi i çrregullimeve të lidhura me risqet e përcaktuar paraprakisht është relativisht i pakomplicuar. Sa më i rëndë të jetë çrregullimi i zhvillimit, aq më lehtë e shpejt do të identifikohet ai nga profesionistët e shëndetit (p.sh: sindroma Down, autizmi). Një tjetër faktor është sektori ku manifestohet vonesa e zhvillimit. P.sh: vonesat në zhvillimin motor identifikohen më lehtë se ato në zhvillimin gjuhësor apo konjitiv. Megjithatë çrregullimet e rënda mund të njihen që në foshnjëri, dëmtimet gjuhësore, hiperaktiviteti dhe çrregullimet emocionale zakonisht nuk diagnostikohen përpara se fëmija të bëhet 3-4 vjeç. Në mënyrë të ngjashme vështirësitë në lexim nuk para diagnostikohen përpara se fëmija të shkojë në shkollë.

Problemet në zhvillimin e fëmijëve mund të manifestohen në një numër mënyrash të ndryshme: në zhvillimin motor, gjuhësor, ndërveprimet personale-sociale, konjicion, etj. Në shumicën e rasteve një gjendje jonormale mund të prekë më shumë se një funksion dhe fëmija mund të ketë një përzjerje çrregullimesh funksionale. P.sh: tek një fëmijë me paralizë cerebrale predominojnë çrregullimet në motorikën globale dhe fine, por ai mund të ketë gjithashtu probleme me komunikimin gjuhësor dhe konjicionin. Ka gjithashtu fëmijë që nuk kanë asnjë manifestim klinik të zhvillimit të vonuar, por që nuk do të jenë në gjendje të arrijnë potencialin e tyre, për arsye se ata nuk marrin stimulimin e përshtatshëm, megjithëse janë të mirëushqyer e të shëndetshëm. Prandaj është e rëndësishme jo vetëm të diagnostikohen problemet, por edhe të promovohen bazat e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijës.

Qëllimi i këtij studimi është ngritja e një sistemi të besueshëm të vlerësimit dhe ndjekjes në vazhdimësi të zhvillimit psikomotor dhe socio-emocional në fëmijërinë e hershme në shërbimin shëndetësor parësor.

Metodologjia

Gjatë periudhës dhjetor 2022 - prill 2023 nëpërmjet një studimi kros-seksional janë depistuar gjithë fëmijët e çerdheve shtetërore të qytetit të Vlorës (N=55) dhe fëmijët e 41 kopshteve shtetërore në këtë qark (N=1221) për zhvillimin psiko-motor me testin ASQ-3 dhe për zhvillimin socio-emocional me testin ASQ-SE 2. Vonesa psikomotore u identifikuan sipas testit ASQ-3 si vlerësime të sektorëve psikomotor, pikët e të cilëve pozicionoheshin në zonat gri dhe të zeza të testimit.

Me këto të dhëna është krijuar një database e zhvillimit të fëmijëve, që administrohet nga Qendra kërkimore-shkencore e Politikave Shëndetësore dhe që do të përditësohet në vazhdimësi në Data Repository e Universitetit të Vlorës.

Rezultatet

Gjatë këtij studimi është vlerësuar zhvillimi psikomotor i gjithë fëmijëve të moshës 0-6 vjeç (N=1276), të rregjistruar në çerdhet dhe kopshtet shtetërore të qytetit dhe fshatrave të Vlorës. Gjithsej u përfshinë në studim 3 çerdhe dhe 19 kopshte në qytet, si dhe 19 kopshte të zonave rurale.

Në tabelën 1 paraqiten karakteristikat e popullatës së marrë në studim, ku shihet një numër pothuaj i barabartë meshkujsh dhe femrash, shumë pak fëmijë që banojnë në zonat rurale dhe një përqindje e lartë fëmijësh mbi 4 vjeç si frekuentues të kopshteve.

Tabela. 1 – Karakteristikat e fëmijëve të marrë në studim.

	numri	përqindja
institucioni		
çerdhe	3	8
kopshte urbane	19	46
kopshte rurale	19	46
fëmijët e vlerësuar me ASQ-3		
çerdhe	55	4
kopshte urbane	1004	79
kopshte rurale	217	17
total	1276	100
gjinia		
femër	634	49.7
mashkull	642	50.3
rezidenca		
rurale	218	17.1
urbane	1058	82.9

grup-mosha (sipas ASQ-3)

12 muajsh	1	.1
14 muajsh	1	.1
16 muajsh	4	.3
18 muajsh	4	.3
22 muajsh	4	.3
24 muajsh	7	.5
27 muajsh	1	.1
30 muajsh	13	1.0
33 muajsh	14	1.1
36 muajsh	20	1.6
42 muajsh	76	6.0
48 muajsh	205	16.1
54 muajsh	205	16.1
60 muajsh	258	20.2

Niveli mesatar i zhvillimit, i matur me testin ASQ-3, tek fëmijëve parashkollorë të regjistruar në kopshtet ditore në qytetin e Vlorës është i kënaqshëm (226.5 pikë nga 300 pikë të mundshme, sipas testit ASQ-3). Po kështu edhe në vlerësimin e niveleve të zhvillimit, pjesa më e madhe e fëmijëve (68.1%) bëjnë pjesë në nivelin e mesëm (201-250 pikë), tabela 2.

Tabela 2 – Klasifikimi i pikëve të marra në ASQ-3

	<i>frekuenca</i>	<i>përqindja</i>
nivel i ulët (0-200 pikë)	206	16.1
nivel mesatar (201-250 pikë)	869	68.1
nivel i lartë (251-300 pikë)	201	15.8

Vetëm 47.4% e fëmijëve paraqisnin një zhvillim psikomotor normal pa asnjë vonesë, në asnjë sektor psikomotor (tabela 3). Ndërkaq 53.6% e fëmijëve kishin të paktën një sektor me vonesë të lehtë (zona gri) apo të rëndësishme (zona e zezë). 31% e fëmijëve paraqesin vonesa në 2 apo më shumë sektorë psikometrikë, ç'ka kërkon një vëmendje më intensive në ambientin edukativ që u krijohet.

Tabela 3 – Numri i fëmijëve me vonesa psikomotore sipas sektorëve të ASQ-3

	<i>0 vonesa</i>	<i>1 vonesë</i>	<i>2 vonesa</i>	<i>3 vonesa</i>	<i>4 vonesa</i>	<i>5 vonesa</i>
frekuenca	605	276	167	125	70	33
përqindje	47.4	21.6	13.1	9.8	5.5	2.6

Sektori psikomotor me nivelin më të ulët të vlerësimit u gjet sektori i Zgjidhjes së Problemeve (Arsyetimi), në të cilin 39.2% e fëmijëve paraqisnin vonesa psikomotore, megjithëse kryesisht vonesa të lehta (tabela 4). Sektori me përqindjen më të lartë të vonesave psikomotore serioze u gjet sektori i Komunikimit me 6.1% të fëmijëve të vlerësuar në zonën e zezë.

Tabela 4 – Zonat e zhvillimit psikomotor sipas sektorëve të ASQ-3

	Sektorët e ASQ-3 (në përqindje)				
	<i>Komunikimi</i>	<i>Motorika globale</i>	<i>Motorika fine</i>	<i>Zgjidhja e problemeve</i>	<i>Sektori personal-social</i>
zona e zezë	6.1	0.4	2.8	4.6	1.6
zona gri	18.8	7.2	24.7	34.6	11.8

zona e bardhë	75.1	92.4	72.5	60.8	86.6
---------------	------	------	------	-------------	------

Në tabelën 5 paraqiten lidhjet midis komponentëve të zhvillimit psikomotor të fëmijëve dhe disa prej variablave të pavarur, të matur në studim. Femrat duket se kanë arritje më të larta se meshkujt në të gjithë komponentët e matur dhe bëjnë sinjifikativisht ($p < 0.005$) vonesa psikomotorë në një nivel më të ulët. Kjo është një tjetër evidencë më shumë pse gjinia femërore ka potencial zhvillimi dhe kapacitetesh më superior ndaj gjinisë mashkullore.

Vendbanimi rural i fëmijëve nuk u pa të kishte ndikim negativ mbi zhvillimin psikomotor të tyre. Përveç sektorit të Zgjidhjes së Problemeve, në të gjithë komponentët e tjerë fëmijët e zonave rurale paraqesin arritje më të larta se fëmijët që jetojnë në zonat urbane. Mesa duket hapësira e veprimit që u krijon ambienti rural ka ndikim sinjifikativ ($p < 0.005$) mbi zhvillimin psikomotor të fëmijës.

Mosha është një tjetër komponent me rritjen e të cilit kemi përmirësimin sinjifikativ ($p = .000$) të të gjithë komponentëve të matur të zhvillimit psikomotor. Kjo nuk vjen prej faktit se mosha është një faktor në vetvete, por për arsyen që vetëm me rritjen e moshës dhe afrimin e kohës për ndjekjen e arsimit shkollor fëmija vihet në qendër të vëmendjes dhe rreth tij krijohet një ambient edukativ e instruksional intensiv. Është e gabuar praktika e këtij investimi të vonuar tek fëmija, jo vetëm për faktin që zhvillimi psikomotor afatgjatë i fëmijës ndikohet nga faktorë që nuk veprojnë vetëm në moshën 5-6 vjeçe (ai varet edhe nga faktorë që veprojnë që gjatë shtatzanisë), por edhe për faktin që zhvillimi psikomotor është një proces kumulativ, ku çdo stad duhet të zhvillohet në potencialin e tij të plotë për ti hapur rrugën tërësisht stadi pasardhës.

Tabela 5 – Shpërndarja e vlerësimit psikomotor sipas karakteristikave të fëmijëve

	gjinia		vendbanimi		grup-mosha sipas ASQ-3 (muaj)				
	femra	meshkuj	rural	urban	36	42	48	54	60
<i>Komunikimi</i>									
zona e zezë	6.3	5.9	3.2	6.7	11.8	5.4	7.3	7.4	4.8
zona gri	16.9	20.7	21.6	18.2	27.6	17.1	20.5	21.3	16.2
zona e bardhë	76.8	73.4	75.2	75.0	60.5	77.6	72.2	71.3	79.0
<i>Motorika globale</i>									
zona e zezë	0.0	0.8	0.0	0.5	1.3	0.5	0.5	0.4	0.2
zona gri	6.5	7.9	7.3	7.2	3.9	9.3	2.4	21.3	1.7
zona e bardhë	93.5	91.3	92.7	92.3	94.7	90.2	97.1	78.3	98.1
<i>Motorika fine</i>									
zona e zezë	1.3	4.4	0.9	3.2	2.6	6.8	1.0	2.7	1.9
zona gri	22.2	27.1	23.9	24.9	36.8	26.3	30.2	27.9	15.6
zona e bardhë	76.5	68.5	75.2	71.9	60.5	66.8	68.8	69.4	82.5
<i>Zgjidhja e problemeve</i>									
zona e zezë	3.3	5.9	1.8	5.2	11.8	3.4	9.3	6.2	1.7
zona gri	34.1	35.0	39.0	33.6	39.5	49.3	31.7	48.4	23.1
zona e bardhë	62.6	59.0	59.2	61.2	48.7	47.3	59.0	45.3	75.2
<i>Sektori personal-social</i>									
zona e zezë	1.4	1.9	0.0	2.0	3.9	2.0	2.0	2.7	0.4
zona gri	10.3	13.2	6.4	12.9	14.5	10.2	8.3	15.1	7.8
zona e bardhë	88.3	84.9	93.6	85.2	81.6	87.8	89.8	82.2	91.8
<i>Klasifikimi i pikëve në ASQ-3</i>									
0-200 pikë	13.2	19.0	16.1	16.2	17.1	22.4	21.5	23.3	6.7

Tabela 5 – Shpërndarja e vlerësimit psikomotor sipas karakteristikave të fëmijëve

	gjinia		vendbanimi		grup-mosha sipas ASQ-3 (muaj)				
	femra	meshkuj	rural	urban	36	42	48	54	60
201-250 pikë	70.2	66.0	79.4	65.8	80.3%	71.2	71.7	67.8	63.1
251-300 pikë	16.6	15.0	4.6	18.1	2.6	6.3	6.8	8.9	30.2
<i>Vonesat psikomotorë</i>									
0-1 vonesa	72.1	65.6	73.4	67.9	53.9	64.4	66.8	58.9	80.8
≥2 vonesa	27.9	34.4	26.6	32.1	46.1	35.6	33.2	41.1	19.2

Situata socio-emocionale e fëmijëve paraqitet shumë e mirë, ku 99.8% e fëmijëve u vlerësuan në zonën e bardhë të testit ASQ-SE (tabela 6), që indikon fëmijë pa trauma emocionale dhe të orientuar më së miri në jetën sociale. Sigurisht që ky studim përfshiu vetëm fëmijë që frekuentojnë kopshtet dhe janë të integruar në bashkëveprimet shoqërore.

Tabela 6 – Zonat e situatës socio-emocionale të fëmijëve sipas ASQ-SE

	frekuenca	përqindja
zona gri	2	.2
zona e bardhë	1274	99.8

Konkluzionet

Niveli mesatar i zhvillimit, i matur me testin ASQ-3, tek fëmijëve parashkollorë të regjistruar në kopshtet ditore në qytetin e Vlorës është i kënaqshëm. Pjesa më e madhe e fëmijëve bëjnë pjesë në nivelin e mesëm (201-250 pikë).

Spektori psikomotor me nivelin më të ulët të vlerësimit u gjet sektori i Zgjidhjes së Problemeve (Arsyetimi). Spektori me përqindjen më të lartë të vonesave psikomotorë serioze (zona e zezë) u gjet sektori i Komunikimit.

Gjinia femërore ka potencial zhvillimi dhe kapacitetesh më superior ndaj gjinisë mashkullore, fëmijët e zonave rurale paraqesin arritje më të larta se fëmijët që jetojnë në zonat urbane. Prindërit merren seriozisht me investimin tek zhvillimi psikomotor i fëmijëve vetëm 1-2 vjet përpara kohës për të filluar shkollën.

Rekomandimet

Monitorimi i zhvillimit psiko-motor të fëmijëve deri në 6 vjeç me anë të testit depistues Age&Stage Questionnaires-3 duhet të jetë pjesë e ndjekjes rutinë të fëmijës nga ana e personelit edukator në kopshte dhe personelit shëndetsor pediatrik në shërbimin parësor.

Leja etike: Zhvillimi i këtij studimi është realizuar fal Marrveshjes specifike të Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë (institucioni përgjegjës për administrimin e çerdheve dhe kopshteve shtetërore) dhe Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit, në të cilën janë përcaktuar kushtet e konfidencialitetit dhe vazhdimësisë së projektit.

Financimi: Ky kërkim është financuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI), Tiranë, Shqipëri, një institucion ligjor publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri. në kuadër të programit të Projekteve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH).

Referencat:

1. Kendall S, Nash A, Braun A, Bastug G, Rougeaux E, Bedford H. **(2019)** Acceptability and understanding of the Ages & Stages Questionnaires®, Third Edition, as part of the Healthy Child Programme 2-year health and development review in England; Vols. Parent and professional perspectives. *Child Care Health Dev.* 2019 Mar;45(2):251-256. doi: 10.1111/cch.12639. PMID: 30661256; PMCID: PMC6849765.
2. Lamsal RD. **(2018)**. Using the ages and stages questionnaire in the general population as a measure for identifying children not at risk of a neurodevelopmental disorder. . *BMC Pediatr* 18, 122 (2018)., <https://doi.org/10.1186/s12887-018-1105-z>.
3. McCall RB, Groark CJ. **(2015)**. Research on institutionalized children: Implications for international child welfare practitioners and policymakers. *International Perspectives in Psychology: Research, Practice, Consultation*, 4(2), 142-159., Vol. <http://dx.doi.org/10.1037/ipp0000033>.
4. Moretti M, Torrecilla M. **(2019)**. Conference: SSBD Workshop Mendoza – Argentina: “Investing in Sustainable Childhoods: Implications for Preventive and Intervention Research” Psychomotor Development of early childhood in alternative care in temporary family foster care. available at: https://www.researchgate.net/publication/351970278_Psychomotor_Development_of_early_childhood_in_alternative_care_in_temporary_family_foster_care
5. Nalven L. **(2017)** “The Impact of Early Orphanage Life on Development”. Available at: <https://www.rainbowkids.com/adoption-stories/the-impact-of-early-orphanage-life-on-development-218>.
6. Otalvaro Romero AM, Grañana N, Gaeto N, Torres Zamblera MN, Vasconez MA, Misenta C, Rouvier ME, Squires J. **(2018)** ASQ-3: Validation of the Ages and Stages Questionnaire for the detection of neurodevelopmental disorders in Argentine children., Vols. *Arch Argent Pediatr.* 2018 Feb 1;116(1):7-13. doi: 10.5546/aap.2018.eng.7.
7. Paul H. Brookes Publishing Co., I. **(2020)**. ASQ-3, . <https://agesandstages.com/products-pricing/asq3/>.
8. Pérez-De La Cruz S, Ramírez I, Maldonado C. **(2020)** Study of Psychomotor Development and Environmental Quality at Shelter Homes for Children Aged 0 to 2 in the Department of Chuquisaca (Bolivia). *Int J Environ Res Public Health.* 2020 Jun 12;17(12):4191. doi: 10.3390/ijerph17124191. PMID: 32545462; PMCID: PMC7344693.
9. Prieto JA, Cueto S, Carballo-Fazanes A, Abelairas-Gómez C. **(2022)** Journal of Human Sport and Exercise. Psychomotor development disorders in apparently healthy children and considerations of family evaluation 2022, 17(3): 518-527. <https://doi.org/10.14198/jhse.2022.173.04>
10. Stanoevska BA. **(2018)**. Preliminary Results of the Macedonian-Adapted Version of Ages and Stages Developmental Questionnaires. . *Journal of neurosciences in rural practice*, 9(4), 510–515., doi: 10.4103/jnrp.jnrp_61_18.

**FAKTORËT AMBIENTALË QË NDIKOJNË PSIKOMOTORIKËN E FËMIJËVE
PARASHKOLLORË**

*Majlinda Rakipaj, Neada Lelaj, Aurela Saliaj, Sonila Nikaj, Emirjona Kiçaj, Evis Alushi,
Enkelejd Mëhilli, Stiliana Brokaj, Vasilika Prifti.*

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit
Bashkia Vlorë
Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Abstrakt

Hyrje: Nëpërmjet bashkëveprimit me ambientin fëmijët sprovohen, pranojnë apo mohojnë strukturat ekzistuese të dijeve. Nëse fëmijës i ofrohen materiale dhe lodra të përshtatshme, ai mund të lozë, të manipulojë, të eksperimentojë me to, në mënyrë që të kuptojë botën që e rrethon dhe të ndërtojë njohuritë e veta.

Qëllimi: Vlerësimi i faktorëve ambientalë që ndikojnë zhvillimitin psiko-motor dhe socio-emocional të fëmijëve.

Metodologjia: Një studim kros-seksional është ndërmarrë gjatë periudhës dhjetor 2022 - prill 2023 me një kampion probabilitar, i rastësishëm i nënave dhe fëmijëve 0-6 vjeç (N=378) në çerdhet dhe kopshtet shtetërore të qytetit të Vlorës. Fëmijët janë vlerësuar për zhvillimin psiko-motor me testin ASQ-3 dhe për zhvillimin socio-emocional me testin ASQ-SE 2, ndërsa nënat janë intervistuar mbi disa komponentë ambientalë që mund të ndikojnë mirërritjen e fëmijës. Pikët e marra në ASQ-3 janë klasifikuar respektivisht: 0-200 pikë – nivel i ulët, 201-250 pikë – nivel i mesëm, 251-300 pikë – nivel i lartë.

Rezultatet: Ushqyerja me gjë është e domosdoshme së paku për 6 muajt e parë të jetës, nëse duam të kemi fëmijë me nivele të larta të zhvillimit psikomotor. Arsimimi i nënës duket se ka ndikim tek zhvillimi psikomotor i fëmijëve, por nuk ka nevojë që nëna të ketë kryer arsim universitar, nënat me arsim të mesëm u gjetën të kishin fëmijë me parametrat më të mirë të zhvillimit. Nënata shtëpiake rrisin fëmijë me parametra lehtësisht më të mirë se nënat e punësuar, por jo me një diferencë sinjifikative ($p > 0.005$). Zhvillimi psikomotor i fëmijëve (niveli i klasifikimit, numri i vonesave psikomotore, disa sektorë psikomotorikë) duket se ndikohet më tepër nga niveli socio-ekonomik i babait sesa i nënës.

Konkluzionet: Duhet të rritet niveli i instruksioneve të promocionit shëndetsor për zhvillimin psikomotor me nënat e fëmijëve me faktor risku (niveli i ulët socio-ekonomik, arsimi tetë-vjeçar, mosha e re e nënës) dhe për ndërgjegjësimin e prindërve për efektin e ambientit stimulues-edukativ në zhvillimin psikomotor të fëmijëve.

Key words: zhvillimi psiko-motor, zhvillimi psiko-emocional, edukimi parashkollor në qytetin e Vlorës.

ENVIRONMENTAL FACTORS AFFECTING THE PSYCHOMOTORICS OF PRESCHOOL CHILDREN.

Majlinda Rakipaj, Aurela Saliaj, Sonila Nikaj, Neada Lelaj, Emirjona Kijaj, Evis Alushi, Enkelejd Mëhilli, Stiliana Brokaj, Vasilika Prifti.

University 'Ismail Qemali' of Vlora, Faculty of Health

City hall of Vlora

National Agency for Scientific Research and Innovation

Introduction

Through interaction with the environment, children test, accept or deny existing knowledge structures. If the child is provided with appropriate materials and toys, he can play, manipulate, experiment with them in order to understand the world around him and build his own knowledge.

Aim

Assessment of environmental factors that influence the psycho-motor and socio-emotional development of children.

Methodology

A cross-sectional study was undertaken during the period December 2022 - April 2023 with a probabilistic, random sample of mothers and children aged 0-6 years (N=378) in state nurseries and kindergartens in the city of Vlora. Children were assessed for psycho-motor development with the ASQ-3 test and for socio-emotional development with the ASQ-SE 2 test, while mothers were interviewed about some environmental components that can affect the child's growth. The points obtained in ASQ-3 are classified respectively: 0-200 points - low level, 201-250 points - medium level, 251-300 points - high level.

Results

Breastfeeding is necessary for at least the first 6 months of life, if we want to have children with high levels of psychomotor development. Mother's education seems to have an impact on children's psychomotor development, but there is no need for the mother to have completed university education, mothers with secondary education were found to have children with the best developmental parameters. Housewives mothers raise children with slightly better parameters than employed mothers, but not with a significant difference ($p > 0.005$). Children's psychomotor development (classification level, number of psychomotor delays, some psychomotor sectors) seems to be more influenced by the father's socio-economic level than the mother's.

Conclusions

The level of health promotion instructions for psychomotor development with mothers of children with risk factors (low socio-economic level, eight-year education, young age of the mother) and for parents' awareness of the effect of the stimulating environment should be increased. - educational in the psychomotor development of children.

Key words: psycho-motor development, psycho-emotional development, preschool education in the city of Vlora.

Modelet ndërvepruese të zhvillimit

E ardhmja e çdo shoqërie varet nga aftësia e saj për tu kujdesur për shëndetin dhe mirëqënien e gjeneratave të reja. Fëmijët e sotëm janë prindërit, punëtorët, qytetarët e së nesërme. Prandaj edhe investimi në zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme është praktikisht investimi për të ardhmen. Vitet e fëmijërisë së hershme janë kritike për zhvillimin e njeriut. Kjo periudhë është baza e zhvillimit të aftësive fizike, emocionale dhe gjuhësore që janë thelbësore për gjithë jetën. Eksperiencat negative në vitet e fëmijërisë së hershme mund ta pengojnë zhvillimin dhe mund të kenë një impakt negativ gjatë gjithë jetës së njeriut. Fëmijët kanë të drejtën të rriten në një ambient që tu lejojë atyre të arrijnë potencialin e tyre të plotë në jetë.

Që nga lindja fëmija nis të influencojë sjelljen e prindërve dhe kujdestarëve. Në përgjigje, prindërit dhe kujdestarët influencojnë fëmijën. Pra, zhvillimi është një proces marrje-dhënieje gjatë të cilit prindërit, kujdestarët, mësuesit dhe fëmija ndërveprojnë vazhdimisht në mënyra që influencojnë sjelljet e njëri-tjetrit. P.sh: një fëmijë i qetë, me ritme të qarta i shpreh nevojat e tij në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme. Ky fëmijë e nis jetën me eksperiencat sociale-personale që janë goxha më të ndryshme nga ato të një fëmije qaraman, të acaruar, ritmet e gjumit dhe të ushqyerjes së të cilit janë të parregullta, e për pasojë stresuese për prindërit. Procesi i ndërveprimit midis prindërve dhe fëmijës mund të ndryshojë kohë pas kohe, e për rrjedhojë do të ndryshojë edhe produkti i zhvillimit.

Studimi i Mijke Rhemtulla 2021 konstatoi se masa e infrastrukturës së përbashkët është probabilitet më e madhe nga sa mund të pritet, ndërsa konfirmuan se faktorët sektorë-specifikë luajnë një rol shumë të madh. Ky studim konfirmoi idenë që për të kuptuar zhvillimin psikomotor në tërësi duhet të kemi parasysh jo vetëm faktorët ambientale dhe gjenetike në vetvete, por gjithashtu edhe ndërveprimin midis tyre (teza e famshme që *‘Gjeni i mirë duhet të ndodhet në ambient të mirë që zhvillohet fuqishëm’*).

Mund të shohim drejtpërdrejtë sesi faktorët ambientale mund të influencojnë njëri-tjetrin, p.sh: cilësia e mësimdhënies mund ti moderojë efektet e statusit socio-ekonomik apo prindërimit. Në mënyrë të ngjashme ka fakte sesi proceset konjitive të nivelit të ulët mund të prekin njëra-tjetrën, p.sh: nëse shpejtësia e perceptimit përmirësohet ajo mund të çojë në zgjatjen e kujtesës aktive (Fry&Hale 2020). Ndërveprime akoma më interesante mund të gjenden midis ambientit dhe proceseve gjenetike. Një numër autorësh kanë propozuar që procesi ndërveprues dinamik individ-ambient ndodh përgjatë kursit të zhvillimit të fëmijës, ku variacionet gjenetike i bëjnë individët e ndryshëm të kërkojnë dhe provojnë eksperiencat ambientale të ndryshme, të cilat nga ana e tyre ndikojnë shumë aspekte të aftësive dhe personaliteteve të tyre (Dickens&Flynn 2021). Fëmijët që janë të rrethuar si në shtëpi, edhe në çerdhe/kopshte, nga një ambient edukativ i fortë, që është njëkohësisht informues dhe mbështetës, mund të kenë një zhvillim më të mirë. EffectivePhilanthropy.com ka raportuar se kërkimet kanë treguar që fëmijët e ekspozuar ndaj një ambienti të varfër dhe të nënprivilegjuar tentojnë të kenë risk më të lartë për tu prekur negativisht në aspektin e zhvillimit.

Shumë studiues janë marrë me studimin e ambientit për të kuptuar sesi ai ndikon mbi fëmijën. Bailey and Wolery (2015) kanë demonstruar se shumë teoricienë zhvillimi konkludojnë në atë që ambienti influencon mbi edukimin, zhvillimin dhe eksperiencat e fëmijëve të vegjël. Studiues të ndryshëm, si Skinner, Piaget dhe Bronfenbrenner theksojnë rëndësinë e disenjimit dhe arredimit të ambientit edukativ. Skinneri sugjeron që është pikërisht ndërveprimi me ambientin ai që formëson sjelljen tonë. Në mbështetje të teorisë bihejvioriste të Skinnerit, roli i ambientit në zhvillimin psiko-motor dhe të mësuarit mund të shpjegohet gjithashtu me teorinë konjitive të Piaget. Sipas Piaget, fëmijët i ndërtojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke punuar me materialet e ambientit. Nëpërmjet bashkëveprimit me ambientin fëmijët sprovohen, pranojnë apo mohojnë strukturat ekzistuese të dijeve. Nëse fëmijës i ofrohen materiale dhe

lodra të përshtatshme, ai mund të lozë, të manipulojë, të eksperimentojë me to, në mënyrë që të kuptojë botën që e rrethon dhe të ndërtojë njohuri të veta. Si Skinneri, dhe Piaget e vënë theksin jo tek ambienti në vetvete, por tek ndërveprimi i fëmijës me të. Ambienti dikton tipin e sjelljeve që janë të përshtatshme apo të papërshtatshme, nxit apo diskurajon eksplorimin, siguron feedback për sjelljen, dhe krijon humorin (gjendjen e përgjithshme shpirtërore) që mund të variojë që nga e gëzueshme dhe entuziaste në e mërëzitur apo frikësuar. Çelësi për ndërhyrjen efektive nga çdo profesionist është të kuptojë këtë marrëdhënie dhe të bindet që ambienti është si një mjet që mund të modifikohet për qëllime intervenuese, ashtu edhe një faktor që duhet marrë në konsideratë kur vendosim pritshmëri realiste për të ndryshuar.

Gjatë fazës së dytë të një studimi nga Phoebe & Arthur Williams, (2017), me fëmijët u realizua një program stimulues për zhvillimin psikomotor në periudhën nga lindja në 8 javë. Si rezultat u konstatua se kombinimi i ndërhyrjes profesionale me aftësitë prindërore të trajnuara mund të prodhojë një performancë psikomotorë më të lartë, të matur me ASQ. Megjithatë nivelin e ulët të arsimimit të nënave në grupin e trajtimit, fëmijët e tyre kapën pikë më të larta në ASQ se fëmijët e grupit të kontrollit – të dhëna këto që sugjerojnë se një program i thjeshtë stimulimi (lodrat muzikore me ngjyra, rake-takja, komunikimi me të porsalindurin) me target të dyfishtë tek nënat dhe fëmijët, mund të prodhojë rezultate spektakolare me kosto të ulët.

Me anë të këtij studimi synohet vlerësimi i disa prej faktorëve ambientale që ndikojnë zhvillimin psikomotor dhe socio-emocional të fëmijëve.

Metodologjia:

Një studim kros-seksional është ndërmarrë gjatë periudhës dhjetor 2022 - prill 2023 me një kampion probabilistik, i rastësishëm i nënave dhe fëmijëve 0-6 vjeç (N=378) në qendër dhe kopshtet shtetërore të qytetit të Vlorës. Fëmijët janë vlerësuar për zhvillimin psikomotor me testin ASQ-3 dhe për zhvillimin socio-emocional me testin ASQ-SE 2, ndërsa nënat janë intervistuar mbi disa komponentë ambientale që mund të ndikojnë mirërritjen e fëmijës. Përpunimi statistikor është realizuar me paketën SPSS.20.

Rezultatet:

Pas një përzgjedhjeje të rastësishme, ku 500 nga 1058 nëna, fëmijët e të cilave frekuentojnë 22 institucionet parashkollore të qytetit të Vlorës, 378 prej tyre pranuan të jepnin disa të dhëna mbi variabla që potencialisht mund të ndikojnë zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Në tabelën 1 paraqiten karakteristikat e fëmijëve të marrë në studim dhe të dhënat e gjetura tek ta. U vu re se një përqindje jo e vogël e nënave (11.6%) nuk raportuan të kishin marrë acid folik si suplement gjatë shtatzanisë, duke e vënë fëmijën në rrezik për probleme të zhvillimit të trurit. Tek ky grup fëmijësh u gjetën përqindje më të larta të nivelit të ulët të zhvillimit (0-200 pikë) krahasuar me grupin e fëmijëve të trajtuar me acid folik gjatë shtatzanisë. Koha e qëndrimit të fëmijëve në cellular mbetet shqetësuese. 77.5% e tyre qëndrojnë 1-2 orë në ditë me cellular në dorë.

Tabela. 1 – Karakteristikat e fëmijëve të marrë në studim.

	numri	përqindja
gjinia		
mashkull	186	49.2
femër	192	50.8
rezidenca		
urbane	378	100
rurale	0	0
grup-mosha (sipas ASQ-3)		
12 muajsh	1	.3

14 muajsh	1	.3
16 muajsh	3	.8
18 muajsh	3	.8
22 muajsh	4	1.1
24 muajsh	4	1.1
27 muajsh	10	2.6
30 muajsh	6	1.6
33 muajsh	9	2.4
36 muajsh	30	7.9
42 muajsh	58	15.3
48 muajsh	56	14.8
54 muajsh	55	14.6
60 muajsh	138	36.5
fëmijë i parëlindur		
Jo	229	60.6
Po	149	39.4
marrja e acidit folik gjatë shtatzanisë		
Jo	44	11.6
Po	334	88.4
ushqyerja me gji		
0 muajsh	12	3.2
1-3 muajsh	27	7.1
4-6 muajsh	60	15.9
7-11 muajsh	60	15.9
12 muajsh	74	19.6
12+ muajsh	144	38.1
koha ditore e qëndrimit në celular		
0 orë	43	11.4
1 orë	167	44.2
2 orë	126	33.3
3 orë	27	7.1
4 orë	5	1.3
5 orë	10	2.6

Karakteristikat e nënave paraqiten në tabelën 2. Përqindja më e madhe e tyre ishin me arsim universitar, por që në përfundim të vlerësimit nuk rezultoi që fëmijët e tyre të kishin parametra zhvillimi më të mirë. Zhvillimi më i mirë psikomotor i fëmijëve u konstatua tek grupi i nënave me arsim të mesëm. Në mënyrë surprizuese parametrat më të mirë të zhvillimit u gjetën tek grupi i nënave që i kishin lindur fëmijët në moshë të hershme (17-20 vjeç). Fëmijët e tyre kishin përqindjet më të larta në nivelin e lartë të klasifikimit ASQ-3 (30.8%), përqindjen më të ulët në nivelin e ulët (7.7%) dhe përqindjen më të ulët të më shumë se 2 vonesave psikomotorë (7%).

Tabela. 2 – Karakteristikat e nënave të marra në studim.

	numri	përqindja
niveli arsimor i nënës		
9-vjeçar	67	17.7
i mesëm	128	33.9
i lartë	183	48.4
ESEC i nënës (klasifikimi socio-ekonomik)		
Pozicione administrative dhe menaxheriale	89	23.5
Pozicione të ndërmjetme	32	8.5
Të vet-punësuar	30	7.9
Shërbime teknike	55	14.6

Pozicione të ulta	13	3.4
Të papunë	159	42.1
grup-mosha e nënës në lindje		
17-20 vite	27	7.2
21-25 vite	122	32.3
26-30 vite	127	33.6
31-35 vite	66	17.5
36-40 vite	36	9.5
niveli i depresionit të nënës (PHQ-9)		
pa depresion	103	27.2
depresion minimal	178	47.1
depression i lehtë	81	21.4
depression i moderuar	14	3.7
depression i rëndë	2	.6

Një numër variablash të pavarur u gjetën të ndikonin sinjifikativisht si faktorë riskantë mbi zhvillimin psikomotor të fëmijëve, si në tërësi, si në sektorë psikomotorë të veçantë (tabela 3). Mosha dhe gjinia e fëmijës janë ndikues në shumicën e sektorëve psikomotorë, në numrin e vonesave që paraqet fëmija, si dhe në nivelin e pikëve që arrin në ASQ-3, Koha ditore e qëndrimit në celular ndikon gjithashtu disa sektorë psikomotor, si Motorika globale, Motorika fine dhe Sektori personal-social. Sektori i Komunikimit nuk dukej se ndikohej nga asnjëri prej faktorëve të marr në studim.

Niveli arsimor i nënës ishte gjithashtu faktor ndikues në zhvillim, me rezultatet më të ulta tek grupi i nënave vetëm me arsim 9 vjeçar, por jo me rezultatet më të larta tek nënat me arsim të lartë. Niveli i depresionit të nënës duket se ka impakt në nivelin e pikëve që fëmijët e tyre arrijnë në ASQ-3, por nuk ndikon deri në zhvillimin e vonesave psikomotores. Zhvillimi psikomotor i fëmijëve duket më shumë i ndikueshëm nga statusi socio-ekonomik (ESEC) i babait sesa i nënës, e kushtëzuar kjo mesa duket nga karakteri i familjes shqiptare ku ndikimi paternal është dominant. Ndërkohë që parametrat socio-emocionalë varen pikërisht nga statusi socio-ekonomik i të dy prindërve.

Tabela 3 – Ndikimi i faktorëve riskantë mbi komponentë të ndryshëm të zhvillimit psikomotor dhe socio-emocional

Zhvillimi psikomotor i fëmijës	Faktorët riskantë	Pearson Chi-Square	Asymp. Sig. (2-sided)
Motorika globale	Koha ditore e qëndrimit në celular	25.173	.005
	Marrja e acidit folik gjatë shtatzanisë	18.348	.000
Motorika fine	Grup-mosha (sipas ASQ-3)	51.334	.002
	Gjinia e fëmijës (femrat)	11.243	.004
	Koha ditore e qëndrimit në celular	21.298	.019
	Niveli arsimor i nënës	17.039	.002
	ESEC i babait (klasifikimi socio-ekonomik)	42.361	.000
Zgjidhja e problemeve	Gjinia e fëmijës (femrat)	6.770	.034
	Grup-mosha (sipas ASQ-3)	72.640	.000
	Gjinia e fëmijës (femrat)	6.139	.046
Sektori personal-social	Koha ditore e qëndrimit në celular	19.824	.031
	Niveli arsimor i nënës	11.959	.018
	ESEC i babait (klasifikimi socio-ekonomik)	25.676	.028
	Grup-mosha (sipas ASQ-3)	116.500	.000

Numri i vonesave psikomodore	Gjinia e fëmijës (femrat)	17.426	.004
	Marrja e acidit folik gjatë shtatzanisë	13.782	.017
	ESEC i babait (klasifikimi socio-ekonomik)	54.241	.020
Më shumë se 2 vonesa psikomodore	Grup-mosha (sipas ASQ-3)	28.309	.008
	Gjinia e fëmijës (femrat)	6.542	.011
	Niveli arsimor i nënës	6.908	.032
ASQ-SE (pikët total)	Niveli arsimor i nënës	41.830	.013
	ESEC i nënës (klasifikimi socio-ekonomik)	79.581	.046
	ESEC i babait (klasifikimi socio-ekonomik)	134.329	.000
Niveli i klasifikimit ASQ-3 i ulët (0-200 pikë) mesatar (201-250 pikë) i lartë (251-300 pikë)	Grup-mosha (sipas ASQ-3)	57.753	.000
	Gjinia e fëmijës (femrat)	10.286	.006
	Ushqyerja me gji më shumë se 6 muaj	458.622	.000
	Niveli arsimor i nënës	13.900	.008
	Niveli i depresionit të nënës (PHQ-9)	21.354	.019
	ESEC i babait (klasifikimi socio-ekonomik)	27.495	.017

Si mund të shihet në tabelën 4, pikët 250+ u kapën vetëm nga fëmijët që ishin ushqyer me gji për më shumë se 6 muaj. Fëmijët e ushqyer me gji deri maksimumi moshën 3 muaj ishin të vetmit që nuk arrinin të merrnin më shumë se 200 pikë në vlerësimin psikomotor.

Tabela 4 – Ndikimi i kohëzgjatjes së ushqyerjes me gji nivelin e pikëve të marra në ASQ-3

Koha e ushqyerjes me gji	Niveli i klasifikimit ASQ-3		
	0-200 pikë	201-250 pikë	251-300 pikë
0-3 muaj	12 30.8%	27 69.2%	0 0.0%
4-6 muaj	0 0.0%	61 100.0%	0 0.0%
6+ muaj	0 0.0%	0 0.0%	278 100.0%

Konkluzionet:

Ky studim evidentoi disa rrethana riskante që ndikojnë sinjifikativisht mbi zhvillimin psikomotor dhe socio-emocional të fëmijës.

- Me rritjen e fëmijës zhvillimi psikomotor vjen duke u përmirësuar.
- Vajzat janë statistikisht më të zhvilluara se djemtë, së paku deri në moshën 6 vjeç.
- Ushqyerja me gji është e domosdoshme së paku për 6 muajt e parë të jetës, nëse duam të kemi fëmijë me nivele të larta të zhvillimit psikomotor.
- Arsimimi i nënës duket se ka ndikim tek zhvillimi psikomotor i fëmijëve, por nuk ka nevojë që nëna të ketë kryer arsim universitar, nënat me arsim të mesëm u gjetën të kishin fëmijë me parametrat më të mirë të zhvillimit.
- Nënës shtëpiake rrisin fëmijë me parametra lehtësisht më të mirë se nënat e punësuar, por jo me një diferencë sinjifikative ($p > 0.005$).
- Zhvillimi psikomotor i fëmijëve (niveli i klasifikimit, numri i vonesave psikomodore, disa sektorë psikomotorikë) duket se ndikohet më tepër nga niveli socio-ekonomik i babait sesa i nënës.

Rekomandimet:

Duhet të rritet niveli i instruksioneve të promocionit shëndetsor për zhvillimin psikomotor me nënat e fëmijëve me faktor risku (niveli i ulët socio-ekonomik, arsimi tetë-vjeçar, ushqyerja me gji) dhe për ndërgjegjësimin e prindërve për efektin e ambientit stimulues-edukativ në zhvillimin psikomotor të fëmijëve.

Leja etike: Zhvillimi i këtij studimi është realizuar fal Marrveshjes specifike të Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë (institucioni përgjegjës për administrimin e çerdheve dhe kopshteve shtetërore) dhe Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit, në të cilën janë përcaktuar kushtet e konfidencialitetit dhe vazhdimësisë së projektit.

Financimi: Ky kërkim është financuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI), Tiranë, Shqipëri, një institucion ligjor publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri, në kuadër të programit të Projekteve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH).

Referencat:

1. Carlos-Oliva D. (2020). Neurodevelopmental development with the use of the Ages and Stages Questionnaire (ASQ-3) in monitoring children's health. *Revista de Neurologia*. , Jan;70(1):12-18. DOI: 10.33588/rn.7001.2019169.
2. Counselling, C. C. (2021). Internet Addiction: Effects On The Brain, Signs, & The Risks. *Ottawa Counselling and Psychotherapy*, pp. <https://capitalchoicecounselling.com/2021/08/internet-addiction-effects-brain-signs-risks/>.
3. Gutierrez-Cruz N, Torres-Mohedas J, Carrasco ML, Olabarrieta-Arnal I, Del Valle F, Garcia ML. (2019) Psychomotor development in late preterms at two years of age: a comparison with full-term newborn infants using two different, Vols. instruments. *Rev Neurol*. 2019 Jun 16;68(12):503-509. doi: 10.33588/rn.6812.2018360.
4. Holický J, Kokštejn J, Musálek M. (2015). Psychomotor development differences between Czech adolescents from orphanages and adolescents from majority society. *Acta Gymnica*, 45(3), 147-154. doi: 10.5507/ag.2015.018.
5. Iyen BV. (2019). Is the apparently protective effect of maternal nicotine replacement therapy (NRT) used in pregnancy on infant development explained by smoking cessation?: secondary analyses of a randomised controlled trial. *BMJ open*, Vols. 9(7), e024923., <https://doi.org/10.1136/bmjopen-2018-024923>.
6. Ralli M, Asimina L, Schiza M, Tsiatsiou A. (2019) "Language and Psychosocial Skills of Institutionalized Children in Greece" *The Open Family Studies Journal* ISSN: 1874-9224., Vols. Volume 11, 2019. Publisher Id: TOFAMSJ-9-76.
7. Gergely Darnai, G. P. (2019). Internet addiction and functional brain networks: task-related fMRI study. *Scientific Reports*, PMID: 31673061. doi: 10.1038/s41598-019-52296-1. .
8. Griškova-Bulanova Inga, Š. D. (2022). How does problematic use of the internet change our brains? *EuroScientist*, <https://www.euroscientist.com/how-does-problematic-use-of-the-internet-change-our-brains/>.
9. Hill, C. E. (2022). How Does Technology Addiction Impact The Brain? *StoneRidge Centers*, pp. <https://stoneridgecenters.com/technology-addiction-and-the-brain/>.
10. Saliaj A, Kola E, Lazaj L, Rakipaj M, Çorraj E. (2013) How The Educational Climate Can Influence The Psychometric Parameters of Preschool Children?, Vols. *European Medical, Health and Pharmaceutical Journal – Central Bohemia University*, ISSN 1804-5804, DOI: <https://doi.org/10.12955/emhpj.v5i0.371>, <http://ojs.journals.cz/index.php/EMHPJ/article/view/371>.